

BASHKIA VLORE

PROJEKT BUXHET

VITI 2023

Pasqyra e Lendes

Projekt vendim për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 20223	3
Kapitulli I: Informacion i përgjithshëm mbi buxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2023	10
Kapitulli II: Parashikimi i të ardhurave në buxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2023	19
II.1. Tabelë përmbledhëse e të ardhurave	23
II.2. Të ardhurat nga taksat vendore	25
II.3. Të ardhurat nga tarifatat vendore	35
II.4. Të ardhura të tjera	48
II.5. Të ardhura nga buxheti i shtetit (transferta e pakushtëzuar) dhe specifike	51
Kapitulli III: Parashikimi shpenzimeve në buxhetin e bashkisë Vlore për vitin 2022	53
III.1. Përmbledhëse e Shpenzimeve	53
III.2. Shpenzime e detajuara në nivel projekti	52
III.2.1. Shpenzime për administratën e bashkisë	56
III.2.2. Shpenzime për përforcuesin	70
III.2.3. Shpenzime për funeral dekorin	70
III.2.4. Pastrimit urban në qytetin e Vlorës	73
III.2.5 Shpenzime Ndërmarrje Menaxhim Mbetje	79
III.2.6. Shpenzime për gjelbërimin	82
III.2.7. Shpenzime për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike	83
III.2.8. Shërbime për ndriçimin rrugor	89
III.2.9. Shpenzime për shumësportin	94
III.2.10. Shpenzime për Qendrën Kulturore	118
III.2.11. Shpenzime për Teatrin “Petro Marko”	120
III.2.12. Shpenzime për arsimin 9 vjeçar	123
III.2.13. Shpenzime për PAK	126
III.2.14. Shpenzime për çerdhet dhe Qendra Komunitare	129
III.2.15. Shpenzime për shtëpinë e fëmijës	135
III.3. Transferta specifike	137
III.3.1. Shpenzime PMNZSH	138
III.3.2. Shpenzime për ujitjen dhe kullimin	140
III.3.3. Shpenzime për administratën e pyjeve	144
III.3.4. Shpenzime për rrugët rurale	146
III.3.5. Shpenzime për arsimin parauniversitar	147
III.3.6. Për arsimin e mesëm	149
III.3.7. Shpenzime për konviktet	150
III.4. Investime	152-164



No. 16320 peal

dt. 19.12.2022.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT VENDIM

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISE PER VITIN 2023

Këshilli i Bashkisë Vlorë, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2022, mbështetur në:

- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c;
- Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 649, date 10.10.2022 “Për propozimin e projekt ligjit te vitit 2023”
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar
- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji nr. 45/2019 “Per mbrojtjen civile”, neni 65.
- Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”
- Udhëzim i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.8, date 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2023-2025”
- V.K.B Nr.X, datë X “Për miratimin e numrit te punonjësve te bashkisë dhe institucioneve te varësisë”.
- V.K.B Nr.X, datë X “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”.

V E N D O S I:

1. Të miratojë të ardhurat si më poshtë (në 000 lekë):	2,560,434
• Te ardhura gjithsej	
a. Të ardhurat e veta	1,438,585

i.	Të ardhura nga taksat vendore	806,950
ii.	Të ardhurat nga tarifat vendore	385,433
iii.	Të ardhura të tjera	246,202
b.	Të ardhura nga granti i pakushtëzuar	674,396
c.	Të ardhura nga transferta speciale	447,453
2.	Të miratojë shpenzimet si më poshtë (ne 000 lekë):	
	Shpenzime gjithsej:	2,560,434
I.	Shpenzime nga granti	674,396
	nga këto:	
a.	Për pagat (art.600)	268,640
b.	Për sigurimet shoqërore (art.601)	44,000
c.	Për shpenzime operative (art.602)	328,106
d.	Fondi i mbrojtjes civile+fondi rezerv (609)	20,000
e.	Transferten (art.166 dhe 651)	13,650
II.	Shpenzime nga të ardhurat	1,438,585
	nga këto:	
a.	Për pagat (art.600)	340,578
b.	Për sigurimet shoqërore (art.601)	56,466
c.	Për shpenzime operative (art.602)	596,653
d.	Për transferta (art.166-651-604-606)	15,593
e.	Për subvencion (art.603 Futbolli , Ujësjellës)	0
f.	Fondi i mbrojtjes civile+fondi rezerv (art.609)	42,954
g.	Për investime (art.231)	386,341
III.	Shpenzime nga transferta specifike	447,453
a.	Për pagat (art.600)	346,408
b.	Për sigurimet shoqërore (art.601)	58,032
c.	Për shpenzime operative (art.602)	43,013

Emertimi	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PER VITIN 2023																							GRANT+TE ARDHURA TOTALI			
	GRANTI											TE ARDHURAT															
	600	601	602	609	651	166	231 TOTALI	600	601	602	603	604	606	609	651	166	231 TOTALI	600	601	602	603	604	606		609	651	166
Administrata e Bashkise	109,140	14,000	20,000		50	2,600	145,790	157,746	31,159	176,492		9,950	2,500			84,769	462,616										608,406
Repartoret			96				96																				96
Mb.Dekor			4,010				4,010																				4,010
Mb.Varreza			10,000				10,000			2,886																	12,886
PMNZH									2,284																		15,961
Administrimi I pyleve dhe																											0
Rrjeti Rrugor																											124,614
Rruget Rurale																											124,614
Pastrimi			220,000					513																			513
NMM	12,000	3,000			2,000	9,000	26,000	15,854	1,652	49,143																	73,120
Gjelberimi	25,000	5,000					30,000	30,450	4,000	8,850																	69,792
Ujesjellesi																											75,040
Nd.Sherb.Publike	35,000	6,000	15,000				56,000	53,939	8,300	45,400																	180,539
Pastrimi nd.sherb.publike	8,000	1,000	3,000				12,000	4,109	1,000	38,550																	57,559
Zhvillimi I komunitetit																											36,779
Nd.Ndrcim rrugor	7,000	1,300	18,000				26,300	2,510	288	97,157																	135,755
Kl.Shumesportesh	8,000	1,200	15,000				24,200	3,362	697	23,707																	71,966
Futbolli																											0
Qendra Kulturore	14,000	2,500	3,000				19,500	14,767	1,616	7,730																	47,613
Teatri Petro Marko	16,000	3,000	3,000				22,000	6,615	600	6,450																	38,865
Arsimi	10,000	2,000	16,000				28,000	20,586	3,107	53,993																	139,552
Qendra PAK	5,000	1,000	1,000				7,000	4,246	470	3,610																	17,326
Cerdhet+Qender	15,000	3,000					18,000	9,174	1,036	7,565																	46,275
Shtepia e Femijes	4,500	1,000					5,500	3,030	257	2,000																	11,557
Fondi I mbrojtes civile+ fq.							20,000																				62,954
Projektet me fonde te huad.																											35,803
SHUMA	268,640	44,000	328,106	20,000	2,050	11,600	674,396	340,578	56,466	596,653	0	9,950	2,500	42,954	1,108	2,035	386,341	1,438,585	2,112,981								

4. Shpenzimet e pikës 2.III do të përdoren si me poshtë:

Kap	Programi	Emërtimi	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2023			
			600	601	602	Totali
4	K03280	PMNZSH	37,187	6,210	2,288	45,685
7	K04240	Ujitja dhe Kullimi	13,515	2,163	27,115	42,793
7	K04260	Administrimi pyjor	5,413	904	142	6,459
8	K04520	Rrugët rurale	2,499	503		3,002
21	K09120	Arsimi Para Universitar (kopshte, Qkf)	246,637	41,480		288,117
22	K09232	Arsimi i mesëm punonjës mbështetës	29,713	4,861		34,574
22	K09240	Konviktet e shkollave profesionale	11,444	1,911	13,468	26,823
		SHUMA I	346408	58032	43013	447,453

5. Shpenzimet për investime sipas pikës 2.II.g do të përdoren për objektet e mëposhtme:

Kapitulli	EMERTIMI	Vlera në mijra leke
	INVESTIME NE TOTAL	386,341
	Investime ne Vazhdim 2022-2023	227,613
1	Ndërtim i sallës së Këshillit Bashkiak Vlore + sistem ngrohje qendrore	67,000
21	Investime në shkolla 9 vjecare	25,000
15	Ndërrhyrje në Fasadat e Pallateve	3,000
8	Rehabilitim i rrugës së Fshatit Drithas	8,000
8	Rehabilitim i rrugës së fshatit Skrofotinë	4,500
8	Riveshje me asfalt e rrugës në fshatin e Radhimës	6,000
8	Riveshje me asfalt e rrugës “Demokracia”, Orikum	8,000
8	Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë	22,000
8	Mbikëqyrje dhe Kolaudim	3,124
1	Skrep për Njësitë Administrative	10,000
15	Shpronësim ne zonat e Qytetit	12,111
8	Rikonstruksioni i rrugëve Orikum, Lagja Gjergj Kastrioti	4,179
8	Rehabilitimi i interseksionit rrugor të aksit kryesor “Shaban Demiraj”	3,500

8	Rehabilitimi i interseksionit rrugor të aksit kryesor "Dhimitër Konomi"	3,000
8	Rikualifikimi i bllokut të banesave të kufizuar nga rr.Çamëria, rr.Pelivan Leskaj, rr.Kujtim Beqiri, rr.Pirro Sava	5,331
15	Shpronësim për subjektet e prekura nga vija e shpronësimit "Rikualifikimi i bllokut të banesave të kufizuar nga rr.Çamëria, rr.Pelivan Leskaj, rr.Kujtim Beqiri, rr.Pirro Sava"	16,000
8	Faza e fundit të rehabilitimit të segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City, rehabilitim i stacioneve të autobusave dhe i stacionit të taksive elektrike	7,000
15	Shpronësim për subjektet e prekura nga vija e shpronësimit "Rehabilitim, riasfaltim i rrugës 'Gjergj Kastrioti' Orikum"	668
	Investime me projekte të huaja IPA	19,200
INVESTIME TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2023		
Blerje pajisje për vitin 2023		12,740
1	Pajisje për arsimin+çerdhe+pajisje për Bashkinë dhe K.B, (elektronike + pajisje zyre)	3,000
17	Pajisje për ndricimin rrugor	9,500
1	Pajisje zyre	240
Investime ne infrastrukture 2023		145,988
Investime ne Institucione Vartëse		50,510
Investime në projekte të huaja IPA		16,603
8	Rikonstruksion i kopshtit nr.11	4,366
8	Rehabilitim , sisitemin dhe asfaltim i rrugëve në blloqe dhe lagje në rajonet 1,2,3,4,5 m2	49,980
8	Rikonstruksion i cerdhes nr 4	3,000
8	Rikonstruksion i cerdhes nr 2	3,000
8	Rikonstruksion i cerdhes nr 15	4,500
8	Rikonstruksion i kopshtit nr 2	3,500
8	Rikonstruksion i kopshtit nr 9	1,000
8	Sisitemim i territorit rreth shkollës Ibrahim Kushta	4,529
15	Përmirësim i kushteve fizike të banesave ekzistuese për shtresat e varfra dhe të pafavorizuara (20 banesa * 1,200 mijë lekë * 25%)	5,000

6. Kuotizacioni për Keshillin e Qarkut Vlorë do të jetë 1% e të ardhurave të arkëtuara në llogari të Bashkisë Vlorë (Në këtë përqindje nuk do të përfshihen të ardhurat që i vijnë Bashkisë Vlorë nga agjentët tatimor dhe të ardhurat e përcaktuara me destinacion, si sponsorizime, kuotizacione që paguajnë prindërit, debitorët e ndryshëm dhe gjoba).

7. Fondi për mbrojtjen civile + fondin rezervë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, mbrojtjen civile si dhe për kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit nr. 65/2019 “Për mbrojtjen civile” është në vlerën 62,954 mijë leke.
8. Për fondin e planifikuar për emergjencën civile autorizohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni Vendor për Emergjencat Civile ta përdorë atë në funksion të realizimit të detyrave për mbrojtjen e popullsisë civile në rastet e fatkeqësive në përputhje me Ligjin Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” dhe VKM Nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe ligjin për emergjencat civile.
9. Kryetari i Bashkisë autorizohet të përdorë fondin prej **7,068 mijë** lekë për vlerësimin financiar të nxënësve cilësorë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të përgjithshme publike të qytetit në bashkëpunim me çdo drejtori shkolle (e mesme dhe 9-vjeçare) nga dy-tre nxënës për çdo shkollë (për nxënësit e shkollave 9-vjeçare 3 mijë lekë, kurse për nxënësit e shkollave të mesme 5 mijë lekë për periudhën janar-qershor).
10. Kryetari i Bashkisë autorizohet të bëjë transferimin e fondeve pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli Bashkiak brenda institucionit dhe transferimin e subvencioneve të miratuara për institucionet përkatëse.
11. Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës për çdo muaj.
12. Si prioritete të investimeve që mund të mbulohen nga burime të tjera financimi nga ministritë e linjes, F.ZH.R apo burime të tjera financimi edhe për vitin 2023 mbeten ato investime të parashikuara si prioritete gjatë vitit 2022 të mëposhtme:

Nr	EMERTIMI	Vlera e investimit (000 leke)
	Prioritetet e investimeve për vitin 2022	
1	Rikonstruksion i teatrit “Petro Marko”, eficaenca energjitike	20,000
2	Rrjeti tercial KUZ Vlorë	80,000
3	Rikonstruksioni i rruges ”Mato Robi”	68,000
4	Rikonstruksion i rruges lagje Koder - Orikm	38,000
5	Rikonstruksion i shkolles “Lef Sallata”	97,000
6	Rikonstruksion i shkollës “Avni Rustemi”	65,000
7	Rikonstruksion i shkollës “15 Tetori”	111,680
8	Rishikimi i projektit të parkimit publik në Lungomare	12,000
9	Rikonceptim dhe Organizim i funksioneve në fushën e Aviacionit	392,000
10	Restaurim dhe Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës	385,000
11	Projektim dhe ndertim i rrugëve të lagjeve, trotuare, lulishteve	150,000

12	Sistemim-asfaltim i rruges Orikum-Kisha e Marmiroit	105,000
13	Sistemim-asfaltim i rruges hyrese Orikum	25,000
14	Rikonstruksion i Shetitores Tragjas	43,000
15	Mirembajtja e rrjetit ujites dhe kullues, fshati Bishan	95,000
16	Sistemim-asfaltim i rruges Hidrovor-Akerni	98,000
17	Sistemim-asfaltim i rruges se fshatit Aliban	21,000
18	Sistemim-asfaltim i rruges Ura Grabian – Rezervuar Fshat	22,000
19	Sistemim-asfaltim i rruges Lapidar Ceprat – Qender Ceprat	24,000
20	Sistemim-asfaltim i rruges Bunavi	22,000
21	Trajtimi i ujrave te ndotur përgjatë Lungomare	1,500,000
22	Rehabilitim i rrugëve të brendshme në lagjen e Romëve, Novoselë	28,000
23	Rehabilitimi i varrezave të dëshmorëve	80,000
24	Rivitalizimi i kanalit të peshkatarëve, qendra e peshkimit të vizitorëve dhe pedonalja përgjatë kanalit	248,800
25	Rikonstruksion i palestrës së Shkollës “4 Heronjtë”	32,000

13. Vendimet e Gjykatave te paguhen për vitin 2023 ne shumen 5,572 mije leke.

14. Për nismen “Nje Mjedis me te Paster” janë planifikuar fondet:

- Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike per sektorin e pastrimit ne shumen 73,120 mije leke i planifikohen fonde per nismen “Një Mjedis më të Pastër” në zërat:
 - a. Pajisje per mirembajtje mjetesh 1,900 mije leke
 - b. Shpenzime operative 41,550 mije leke
 - c. Cdo diference e ngelur nga prokurimet të kalojë në favor të fondit për nismën “Një Mjedis më të Pastër”, nëse do të nevojiten fonde shtesë
- Në sektorin e Gjelbërimit janë planifikuar 75,040 mijë lekë
- Pastrimi urban në të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë – 293,120 mijë lekë
- Ndermarrja e Menaxhimit të Mbetjeve – 95,792 mijë lekë

15. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Konceptoi: *Daut Zeraj*



Sonela Haxhiraj

KRYETARI
Dritan Leli



KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË VLORË PËR VITIN 2023

I. Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i Buxhetit 2023.

Buxheti është tërësia e te ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore të planifikuar, miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e bashkisë. Me tej buxheti vendor përfshin një fond rezerve dhe një fond kontigjence, e mbi bazën e këtyre parimeve, ky buxhet është hartuar në zbatim të legjislacionit të mëposhtëm:

- a. Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- b. Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- c. Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë “ndryshuar.
- d. Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- e. Ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- f. Ligjit 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”
- g. Ligjit 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- h. Ligjit 10405, “Për Kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”
- i. Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”
- j. Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
- k. Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, date 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”
- l. V.K.B Nr. datë “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë”.
- m. V.K.B Nr. datë “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, i ndryshuar.
- n. Ligje dhe akte të tjera ligjore

Prioritetet e qytetarëve të Bashkisë Vlorë për buxhetin 2023

Duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 neni 16 pika 1 “Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes” si dhe ligjit nr. 68, date 27.04.2017 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 5, pika ç “Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.”, administrata e Bashkisë Vlorë ka kryer një seri konsultimesh me komunitetin dhe grupet e interesit në njesite administrative si dhe rajonet e qytetit sipas një agjende të përcaktuar në kalendar. Vec konsultimeve të administrates të

bashkise janë vleresuar dhe të dhënat e administrara nga Qendra Rinore Vlore e cila nepermjet pyetesoreve dhe sondazheve të realizuara prej saj ka percaktuar disa nga prioritetet e kerkesave të qytetareve referuar sherbimeve qe ofron Bashkia Vlore si organ i qeverisjes vendore.

Konkretisht Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të Përmirësimit të Procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje dhe POP – Kontrata Sociale, mjet për të forcuar marrëdhëniet midis qytetarëve dhe të zgjedhurve vendor, mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, ka mbledhur prioritetet e qytetarëve për rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashki me anë të një instrumenti efikas, siç. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkisë është shpërndarë një pyetësor online, ku çdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Të dhënat e mbledhura online, janë përpunuar dhe analizuar duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, synohet informimi i autoriteteve vendore mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

1. Të dhënat e mbledhura në Bashkinë Vlorë

Nga bashkia Vlorë, **642** qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët **300** janë *meshkuj* dhe **342** janë *femra*.

Fig. 1 Të anketuarit sipas gjinisë





Fig. 2 Të anketuarit sipas moshës



Anketimi është shpërndarë qytetarëve në të gjithë bashkinë Vlorë, duke përfshirë qytetin dhe njësitë administrative Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Qendër. Pjesa më e madhe e qytetarëve që kanë plotësuar formularin janë nga qyteti i Vlorës, ndjekur nga njësitë administrative Orikum, Novoselë dhe Qendër, ndërsa pjesëmarrja më e vogël ka qenë në njësinë administrative Shushicë. Përkatësisht 388 qytetarë nga Vlora, 91 qytetarë nga Nj.A Novoselë, 80 qytetarë nga Nj.A Orikum, 46 qytetarë nga Nj.A Qendër dhe 37 qytetarë nga Nj.A Shushicë.




Fig. 3 Të anketuarit sipas vendbanimit

2. Kategoritë e buxhetit

Nga të dhënat e përpunuara vërehet se ndër kategoritë e buxhetit ajo që është votuar si kryesorja nga qytetarët dhe ka më tepër prioritet për ta është **Infrastruktura dhe Shërbimet Publike** vlerësuar nga **25,2%** e qytetarëve (162 persona), ndjekur nga **Zhvillimi Ekonomik Vendor** me **12.6%** (81 persona). Më pas vijnë **Mbrojtja e Mjedisit** vlerësuar nga **12.5%** e qytetarëve (78 persona), **Shërbimet Sociale** vlerësohen nga 76 persona, në **11.8%** ndërsa investimet në **Arsim** vlerësohen nga 74 persona të shprehura në **11.5%**.

Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pyjet dhe Kullotat vlerësohen si zëra të rëndësishëm në buxhetin bashkiak nga **10.59%** e qytetarëve (68 persona), që vazhdon me **Kultura, Sporti dhe Shërbimet Argëtuese** gjithashtu vlerësuar nga **9.6 %** e qytetarëve (62 persona). **Siguria Publike** me **3.89 %** (25 persona). Prioriteti më pak i votuar është **Demokracia Vendore** me **2.49 %** (16 persona).




Fig. 4 Kategoritë e buxhetit

3. Nënkatëgoritë e buxhetit

Nga analiza e prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve të shprehura përmes komenteve në pyetësor (3 prioritete kryesore zgjedhur nga çdo person) rezulton një shpërndarje në zërat e buxhetit si në tabelë:

Zërat e buxhetit	Përqindja
Investime në infrastrukturën rrugore	55%
Ujësjetllës kanalizime	47%
Shërbimi i pastrimit	39%
Ndriçimi publik	23%
Zhvillimi ekonomik	22%
Sipërfaqe të gjelbërta	19%
Shërbimi i transportit	16%
Mirëmbajtja e godinave të shkollave	16%
Ujitja dhe kullimi	14%
Turizmi, Sportet dhe Kultura	14%

Tab.1 Zërat e buxhetit

Vërehet se qytetarët kanë si prioritet kryesor ndërhyrjet në *Investimet në infrastrukturën rrugore* (55% e qytetarëve); *Ujësjetllës Kanalizimet* (47% e qytetarëve) dhe *Shërbimi i Pastrimit* (39% e qytetarëve).

Renditje mesatare kanë prioritetet e lidhura me *Ndriçimin Publik* (23% e qytetarëve), *Zhvillimin ekonomik* (22% e qytetarëve), *Sipërfaqe të gjelbërta* (19% e qytetarëve) dhe *Shërbimi i Transportit* (16% e qytetarëve).

Më poshtë në renditje janë prioritetet që kanë të bëjnë me *Mirëmbajtjen e godinave të shkollave* (16% e qytetarëve), *Ujitjen dhe kullimin* (votuar nga 14% e qytetarëve) dhe *Turizmin, Sportet dhe Kulturën* (14% e qytetarëve).

4. Prioritetet kryesore sipas gjinisë




Fig. 5 Prioritetet sipas gjinisë

Në grafik, paraqiten prioritetet sipas gjinisë. Vërehet se prioritetet kryesore të vajzave dhe grave janë *Investimet në infrastrukturën rrugore* (26%), *Shërbimi i transportit* (18%), ndjekur nga *Ndriçimi publik* (14%).

Në prioritetet e djemve dhe burrave është votuar më së shumti për *Investime në infrastrukturën rrugore* (24%), duke vazhduar me *Shërbimin e pastrimit* (20%) dhe *Ujësjetllës kanalizimet* (18%).

5. Prioritetet sipas moshës




Fig. 5 Prioritetet sipas moshës

Vihet re se nga grupmosha **15-25 vjeç** janë kërkuar më tepër *Turizmi dhe Kultura* (14%), *Zhvillimi ekonomik* (12%) dhe *Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive* (8%).

Në prioritetet e kërkuara më tepër nga mosha **26-35 vjeç** renditen *Zhvillimi ekonomik* (11%), *Shërbimi i pastrimit* (10%), dhe *Investime në Infrastrukturën Rrugore* (7%).

Në prioritetet e moshës **36-45 vjeç** janë votuar më tepër *Investime në infrastrukturën rrugore* (15%), *Ujësjetllës kanalizime* (14%) dhe *Shërbimi i transportit* (12%).

Mosha **46-55 vjeç** ka vendosur si prioritate *Investime në infrastrukturën rrugore* (16%), *Ujësjetllës kanalizime* (15%) dhe *Shërbimi i ujitjes dhe kullimit* (14%)

Në prioritetet e moshës mbi 55 vjeç janë kryesore sërish *Investimet në infrastrukturën rrugore* (18%), *Ujësjellës kanalizime* (18%), dhe *Shërbimi i pastrimit* (14%).

6. Sugjerimet specifike të qytetarëve të Vlorës që kanë marrë pjesë në votimin online.

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

- **Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit në qytet ose njësi administrative.**

I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe ndriçimin në lagjet “Pavarësia” dhe “Hajro Çakëri”; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në lagjen “Kushtrimi”; Rikonstruksioni i rrugës “Prenjo Petoshati”, Lagjia “24 Maji”; Ndërhyrje në infrastrukturë në lagjen “10 Korriku”, rruga “Daut Metushi”; Përmirësimi i infrastrukturës në lagjen “1 Maj” tek rruga në periferi të lagjes ku mungon infrastruktura rrugore; Investim në infrastrukturën rrugore në lagjen “11 Janari”; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në rrugën “Shtjefen Gjeçovi”; Lagjia “10 Korriku”, Rruga “Donika Kastrioti” me probleme të theksuara ka nevojë për investim në infrastrukturën rrugore dhe ndriçim; Shtrimi i trotuareve në zonën e Kuzum Babasë, pasi banorët, rrezikojnë jetën duke ecur në korsinë e makinave; Riparimi i rrugës pranë shkollës “Lef Sallata” e cila përmbytet në sezonin reshjeve dhe vështirëson kalimin a nxënësve; Ndërhyrje në infrastrukturë në rrugën e fshatit Radhimë; Rikonstruksioni i trotuarit tek rruga “Misto Mele” dhe ndërhyrje në sistemin e ndriçimit; Shtrimi i rrugës mes bllokut të ri përballë ish-shtepisë së oficerave; Rikonstruksioni i rrugës “Kostandin Kristoforidhi” te Kisha Katolike; Rikonstruksioni i rrugës “Jani Gjonçari” pas monumentit të Pavarësisë; Ndërhyrje në infrastrukturë në lagjen “28 nëntori”, (blloku i banimit pas kopshtit nr. 10, nga pjesa e pasme e pallatit te L-ja deri te rruga “Pilo Begaj”); Rikonstruksioni i rrugës “Dhimitër Konomi”, ose siç njihet me termin unaza e re, pas dëmtimit nga projekti i ujësjellësit; Ndërhyrje në rrugën përballë shkollës “Ismail Qemali” Lagjia “Isa Boletini”; Shtrimi i rrugës “Shaban Demiraj”. Në **Novoselë**: Ka nevojë për ndërhyrje në rrugët e brendshme të fshatrave Aliban, Fitore, Delisuf, Poro, Cerkovinë, Trevllazër, Mifol dhe rrugët e varrezave të fshatrave Cerkovinë, Trevllazër, Mifol. Hapja e rrugëve për në parcelat bujqësore; Ndricimi i rrugës Kristo Bena në Skrofotinë. Në **Orikum**: Ndërhyrje në rrugët e brendshme dhe blloqet e banimit në Orikum, rruga buzë detit është bërë vetëm nga njëra anë, duhet bërë ana tjetër deri tek postblloku i vjetër. Në **NJA Qendër Vlorë**: Kërkohe ndërhyrje në rrugët e Bestrovës dhe Panajasë dhe në rrugët e brendshme. **Shushicë**: Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse Risili-Çepirat-Bunavi.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

- **Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për:**

Rajonet e qytetit të Vlorës: Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm në qytet dhe zgjatja e orarit të furnizimit me ujë në të gjithë qytetin. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm në lagjet “Hajro Çakëri”, “Kushtrim” dhe “10 Korriku; Zgjidhja e problemit të mungesës së ujit të pijshëm në lagjen “Lirim”. Kërkohe ndërhyrje cilësore dhe përfundim i rrjetit të ujësjellësit në zonën e Ujit të Ftohtë-Lungomare – Rrapë Ujë i ftohtë – Shkolla e Marinës; përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat periferike të Vlorës (zona Transballkanike). **Novoselë**: Kërkohe të planifikohet ndryshimi i projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të 15 fshatrave në Nj.a Novoselë duke kërkuar përfshirjen e rrjetit të brendshëm nga Alibani deri në Akëri dhe në

Kërkovë. **Orikum:** Zgjatja e orarit të furnizimit me ujë të pijshëm në Orikum. **Qendër:** Zëvendësim rrjeti dhe përmirësim të shërbimit të shpërndarjes së ujit të pijshëm në Kaninë, Sherishtë, Zvërnec, Nartë. **Në Nj.A Shushicë:** Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë dhe cilësisë së ujit. Depoja e ujit në Drithas nuk e përballon furnizimin me ujë, ka nevojë të gjendet një zgjidhje.

KANALIZIMET

- **Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësive vijuese: Rajonet e qytetit Vlorë:**

Pastrimi i kanalizimeve për të parandaluar përmytjet në kohën e reshjeve. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike të qytetit. Pastrimi i kanalit në lagjen “Kushtrimi”; Ndërhyrje në kanalizimet e ujërave të zeza në lagjen “Kushtrimi”; Riparimi i çarjeve të tubave të ujit/kanalizimeve në lagjen “Hajro Çakëri” rruga “Xhemil Bej Vlora”, zona e Kuzum Babasë të cilat rrezikojnë muret e banesave; Ndërhyrje në infrastrukturë pellgjet sezonale të ujit që krijohen në rrugën Ali Demi apo sic quhet ndryshe dhe rruga e spitalit; Pastrimi i kanalit të Fusha e Aviacionit; Në **Novoselë:** Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, sidomos në fshatrat Mifol dhe Akëri, si dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Panaja. Gjithsesi gjithë Nj.A nuk ka rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza. Në **Orikum:** Kullimi i pjesës së kënetës që është bërë vatër infeksioni duke krijuar shqetësim për banorët e zonës dhe turistët gjatë verës. Pastrimi i kanaleve kullues dhe ndërhyrje për sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza që vazhdojnë të derdhen në det. Në Nj.A **Qendër Vlorë:** Rikonstruksioni i rrjetit të ujërave të ndotura në fshatrat Bestrovë, Kërkovë, Panaja, Oshtimë, Shershtë, Babicë, Kaninë, Zvërnec, Nartë. Ndërsa në Nj.A **Shushicë:** Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura. Kërkohet zgjidhja e problemit të përmytjeve në Risili.

PASTRIMI DHE GJELBËRIMI

Kërkohet përmirësimi i cilësisë së pastrimit të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik si dhe të vihet në funksion vendepozitimi i mbeturinave (landfilli në Sherishtë) Pastrimi i lagjeve të brendshme në qytet dhe në pika të veçanta. Përmirësimi i shërbimit të pastrimit në lagjen “Pavarësia”; Pastrimi i pjesëve anësore të rrugës Xhemil Bej Vlora, zona e Kuzum Babasë nga mbeturinat dhe bimët e paprera të cilat mund të bëhen burim aksidenti; Përmirësimi i shërbimit të pastrimit lagjen “Partizani”;

TRANSPORTI PUBLIK

Përmirësimi i shërbimit të transportit publik në Vlorë dhe ofrimi i shërbimit në njësitë administrative dhe lagjet periferike të qytetit, me orare dhe tabela informuese. Qytetarët kërkojnë orare fikse, afishimi i linjave dhe orareve pranë stacioneve dhe në pikat kryesore. Në Nj.A Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë të gjithë banorët e njësive administrative kërkojnë që gjatë periudhës së sezonit turistik të jenë funksionale linjat e transportit.

TË TJERA

Përfundimi i menaxhimit të tokave bujqësore. Pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse; Përmirësimi i sigurisë publike në lagjen “Hajro Çakëri”; Shtimi i hapësirave argëtuese për të rinjtë në Vlorë; Vendosja e sanksioneve për ndotjen e tokës, ujit, ndotjen akustike dhe zbatimi i tyre; Më shumë evente kulturore për të rinjtë në Vlorë dhe njësitë administrative; Vendosja e

një sensi kalimi për makinat në lagjen “29 Nëntori” tek kompleksi i pallateve San Marino; asistencë për punësimin rinor përmes informimit dhe punësimit të tyre në sektorin e turizmit.

Edhe nga konsultimet e administratës të bashkisë me grupet e interesit gjate dëgjësave publike për programin buxhetor afatmesëm si dhe buxhetin e vitit 2023 problematika e trajtuar lidhur me kërkesat për shërbimet nga Bashkia Vlorë pothuaj, është e njëjtë. Si prioritet I parë është infrastruktura publike, uji i pijshëm, kanalizimet, këto vecanërisht në njësitë administrative dhe fshatra infrastruktura e kopshteve, cerdheve etj. Janë pikërisht këto prioritet të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit 2023 të cilin e paraqesim për miratim në këshillin e bashkisë. Veçanërisht rëndësi në këtë buxhet I është kushtuar rehabilitimit, sistemit dhe asfaltimit të rrugëve në blloqe sipas rajoneve për të cilat gjatë dëgjësave publike janë paraqitur kërkesa dhe vlera e tyre mund të përballohet nga ky buxhet pasi kostot e rehabilitimit sipas zonave nuk janë shumë të larta. Vetëm për këtë qëllim në këtë buxhet janë parashikuar afërsisht 50000 mijë lekë investime për një sipërfaqe prej afërsisht 22500 m2.

Për hartimin e këtij buxheti me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlore është ngritur Grupi i Punës Për Hartimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe Ndryshimeve të Mundshme në Paktën Fiskale si për menaxhimin dhe sigurimin e zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar në përgatitjen e programit që po ju paraqesim.

Në ligjin 139/2015 janë përcaktuar qartë funksionet dhe kompetencat e Njesisë së Vetëqeverisjes vendore dhe hartimi i Buxhetit të tyre. Konkretisht në nenin 41 “Buxheti Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe program buxhetor afatmesëm” kërkohet:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.
- Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:
 - Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh përfshirë edhe shlyerjen e borxhit të njësisë.
 - Të gjitha transfertat të parashikuara për tu marrë nga qeveria qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre.
 - Të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për tu siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë Bashkisë nga çfarëdo burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifatat, vlerësimet, gjobat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes.
 - Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse, parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:

i. Qëllimin e investimit

ii. planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit

- iii. shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit.
- Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Ne zbatim të përmbushjes së detyrimeve ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj si dhe prioriteteve të komunitetit është hartuar buxheti i Bashkisë Vlore për vitin 2023 në vlerën 2,545,934 mije lekë nga të cilat 1,424,085 mije lekë nga të ardhurat e veta ose 56 %, 674,396 mije lekë Transferta e Pakushtëzuar ose 26.4%; 447,454 mije leke Transferten Specifike ose 17.6%.

Buxheti sipas programeve buxhetore paraqitet si më poshtë:

Kapitulli	Emërtimi I Programit Buxhetor	Vlera ne 000 leke	% ndaj buxhetit
1	Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	593,906	23.50%
2	Shërbime të përgjithshme	16,992	0.67%
4	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	61,646	2.57%
7	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	49,252	1.94%
8	Shërbime publike	180,539	7.29%
8	Rrjeti rrugor	128129	5.03%
10	Gjelberimi	75040	2.95%
10	Menaxhimi i mbetjeve	446471	17.63%
11	Menaxhimi i ujërave të zeza		
15	Zhvillimi i komunitetit	36,779	1.44%
17	Ndriçimi i rrugëve	135,755	5.39%
19	Shërbimet rekreative dhe sportive	71,966	3.39%
20	Shërbimet kulturore	86,478	3.40%
21	Arsimi bazë dhe parashkollor	402,669	15.82%
22	Arsimi i mesëm	86,397	2.39%
24	Kujdesi Social për të sëmurë dhe PAK	17,326	0.68%
26	Familje dhe fëmijët	57,832	2.27%
	Fondi Rezerve+fondi i mbrojtjes civile	62,954	2.24%
	Projektet e huaja	35,803	1.40%
	Totali	2,545,934	100%

Ndërsa sipas klasifikimit ekonomik të llogarive buxhetore dhe përqindjes që secili zë shpenzimesh zë në totalin e shpenzimeve buxhetore për të ardhurat e veta për vitin 2023, treguesit jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela 2

Programi	Paga +Sig Shoq	Shpenz. Operative	Rezerve+ Emergjencia	investime	Te tjera	Totali
Totali	397,044	592,153	42,954	376,341	15,593	1,424,085

II. Objektivat e buxhetit të vitit 2023.

Objektivat e buxhetit të vitit 2023 janë te pandara me objektivat e buxhetit afatmesëm 2023-2025 ku prioritet e zhvillimit bazohen në Planin e Përgjithshëm Vendor 2017-30, si dokumenti baze i cili është përgatitur me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, dhe është një mjet kyç i planifikimit të përdorur dhe do të formojnë të ardhmen e qytetit.

Dokumenti ka identifikuar një seri prioritetesh kyçe ekonomike për bashkinë gjatë kësaj periudhe. Fokusi i Planit të Zhvillimit të Vlorës mund të përmblihet në fushat e mëposhtme:

- Vazhdimi i përmirësimit të konkureshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik
- Vazhdimi i zhvillimit të zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
- Vazhdimi i nxitjes së sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
- Vazhdimi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
- Përmirësimi i pastrimit të mjedisit në kuadrin e iniciativës së Qeverisë Shqipëtare për një Shqipëri të Pastër.

Motoja e punës së Bashkisë Vlorë për vitin 2023: Patriotizmi fillon nga mbrojtja e mjedisit të vendit tënd, në radhë të parë duke mos i hedhur plehrat rrugëve, parqeve, plazheve, po duke e konsideruar tokën e atdheut dysheme të shtëpisë që e ke trashëgim nga ata që e banuan para teje dhe duhet t'ia lesh të pastër atyre që do të vijnë pas teje. Të bashkuar punët kanë gjithnjë rezultate më të mira prandaj angazhimi i këtyre kohëve në pastrimin e territorit do të vijojë me të njëjtën frymë.

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2023 është një buxhet i balancuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve i programuar në vlerën 2,545,934,000 lekë.

KAPITULLI II: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NË BUXHETIN E BASHKISË VLORE PËR VITIN 2023

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifrat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore,

donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësive vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2023 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vlore, nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë **2,545,934 mijë lekë**.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:


1. Nga burimet e Buxhetit të Shtetit ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e bashkisë..
2. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifatat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore).

NR.	EMERTIMI	Fakt 2020	Fakt 2021	I Pritshëm 2022	Plan 2023
1	Te ardhurat nga taksat e tarifatat te vitit korrent	823,127	1,320,237	1,368,643	1,424,085
2	Te ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm	83,428	85,504	198,614	0
3	Transferta e pakushtëzuar	511,855	548,229	520,000	674,396
4	Transferta e pakushtëzuar nga viti i mëparshëm	37,744	51,690	164,859	0
5	Transferta specifike	322,924	412,452	400,000	447,453
6	Transferta specifike nga viti i mëparshëm	54,110	67,147	100,143	0
	T O T A L I	1,749,760	2,399,755	2,553,645	2,545,934

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të Bashkisë Vlore me parashikim prej **1,424,085 mijë lekë**, dhe zënë 56% të totalit të të ardhurave.

Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e pakushtëzuar) prej **674,396 mijë lekë** zënë 26% të totalit të të ardhurave

Për vitin 2023 krahas transfertës së pakushtëzuar është akorduar edhe fondi transfertat specifike prej **447,453 mijë lekë** ose 18% për funksionet e transferuara.



II.1. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore për vitin 2023 janë programuar në shumën **1,424,085 mijë leke**

Bashkia Vlore veprimtarinë fiskale e mbështet në këtë bazë ligjore:

- Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar
- Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, me ligjin 181/2013 dt. 28/12/2013, botuar në fletoren zyrtare nr.203, dt.30/12/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt.30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar".
- V.K.B Nr.79, datë 02.12.2021 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë".


Bashkia Vlorë, garanton funksionin e saj, nëpërmjet taksave të parashikuara në ligj sipas akteve ligjore, ashtu edhe taksat e përkohshme dhe tarifatat, të miratuara nga Keshilli i Bashkisë.

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.
2. Taksa e mjeteve të përdorura.
3. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
4. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesë + toke bujqësore).
5. Taksa e truallit.
6. Taksa e fjetjes në hotel.
7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja.

8. Taksa e tabelës.
9. Taksë parkimi.
10. Taksa mbi të ardhurat personale.
11. Tarifa për zënien e hapësirave publike.
12. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
13. Tarifa e shërbimit për subjektet me aktivitet ndërtimi.
14. Tarifa për shërbime të tjera nga pushteti vendor.
15. Tarifa për leje dhe çertifikata transporti.
16. Tarifa e shërbimit të ujitjes.
17. Të ardhura të tjera (nga qiratë, mjete, godine, tokë).
18. Të ardhura nga aplikim gjobash..
19. Të ardhura nga kopshte, çerdhe e shkolla.
20. Të ardhura nga institucionet vartësë.
21. Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuara.

Ky grup taksash dhe tarifash përbëhet nga:

1. Të ardhura tatimore
2. Të ardhura jo tatimore.



Pasqyra përmblledhëse e të ardhurave për vitin 2023

Nr.	EMERTIMI	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2022	I pritsëm 2022	Plan 2023
I	Të ardhura nga taksat vendore	491,247	569,445	766,957	689,508	806,950
I.1	Të ardhura nga Agjentët Tatimor	108,444	110,517	123,600	110,060	118,900
1	Taksë për kalimin e së drejtës së pronësisë	29,159	27,905	30,000	30,000	31,000
2	Taksë e automjeteve të përdonura	65,964	70,475	75,600	77,600	83,400
3	Taksa e biznesit të vogël (Tatim i Thjeshtuar)	13,321	12,137	18,000	2,460	4,500
I.2	Taksë e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat+toka)	382,803	458,928	643,357	579,448	688,050
1	Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesa	116,645	191,418	250,732	190,000	250,198
2	Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore	13,175	13,562	38,758	13,500	38,739
3	Taksë trualli	11,156	12,212	12,371	11,500	12,418
4	Taksë e fjetjes në hotel	5,469	14,915	18,743	18,500	20,635
5	Taksë e ndikimit në infrastrukturë (Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit)	205,336	180,941	298,853	315,000	334,186
6	Taksë table + reklame	5,413	11,709	11,00	14,000	14,020
7	Taksë parkimi	1,339	2,03	1,900	2,500	2,856
	Taksa mbi të ardhurat Personale	24,270	32,133	11,000	14,448	15,000
II	Të ardhurat nga tarifatat vendore	160,103	357,667	351,620	295,500	385,433
1	Tarifë për zenien e hapësirave publike				69,500	94,163
1.1	Tarifë tregu	16,567	7,282	5,640	5,000	
1.2	Tarifë e zenies së hapësirave publike	28,064	74,780	78,996	64,500	
2	Tarifë vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjëlberim	107,756	231,468	235,284	195,000	256,917
3	Tarifë shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi		18,690	14,164	15,000	14,164
4	Tarifë për leje dhe shërbim veterinar	19	1,800	0	0	0
5	Tarifë për shërbime të tjera nga pushteti vendor	3,764	8,684	5,033	4,500	5,033
6	Tarifë për leje dhe çertifikata transporti	3,933	10,980	8,520	10,500	11,173
7	Tarifa e Ujitjes		3,983	3,983	1,000	3,983
III	Të ardhura të tjera	80,566	239,901	210,451	156,326	175,001
1	Të ardhura nga qirata (mjete+godine+toke)	2,439	41,325	41,325	10,500	41,325
2	Të ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	70,331	177,750	148,300	125,00	112,850
3	Të ardhura nga kopshet, çerdhet dhe shkollat	7,796	20,826	20,826	20,826	20,826
4	Të ardhura nga institucionet vartëse	7,783	153,22	70,920	227,309	71,201
4.1	Të ardhura nga teatri "Petro Marko"	375	550	550	550	550
4.2	Të ardhura nga Qendra Kulturore	876	1575	1,550	1,550	1,775
4.3	Të ardhura nga Shumesportet		595	595	595	651
4.4	Të ardhura nga ndërmanja Shërbimeve Publike		300	300	300	300
4.5	Të ardhura nga pullat		700	700	700	700
	Projekte	6,532	64,000	67,225	25,000	67,225
5	Të ardhura të trashëguara	83,428	85,504		198,614	
IV	TOTALI I TË ARDHURAVE (Taksa Tarifa)	823,127	1,320,237	1,399,948	1,368,643	1,438,585
1	transferata e pakushtëzuar	511,855	548,229	565,117	520,000	674,396
2	transferata e pakushtëzuar e trashëguar	37,744	51,690		164,859	
V	Total Transferata e pakushtëzuar	549,599	599,919	565,117	684,859	674,396
VI	Transferata e Pakushtëzuar + të Ardhurat e Veta	1,372,726	1,920,156	1,965,065	2,053,502	2,112,981
1	transferata e pakushtëzuar sektoriale	322,924	412,452	429,407	400,000	447,453
2	transferata e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar	54,110	67,147		100,143	
VII	total transferata e pakushtëzuar sektoriale	377,03	479,599	429,407	500,143	447,453
	buxheti I përgjithshëm	1,749,760	2,399,755	2,394,472	2,553,645	2,560,434

- **Të ardhura tatimore.**

Per vitin fiskal 2023 këto të ardhura arrijne ne shumen **792,450 mije leke**. Ne kete grup te ardhurash, peshen kryesore specifike e ze zeri " Taksa mbi Ndertesen", si dhe zeri "Takse e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja dhe takse e automjeteve".

- **Te ardhura jo tatimore.**

Te ardhurat jo tatimore per vitin 2023 parashikohen ne rreth **631,635 mije leke**.

Nje ecuri e te ardhurave per periudhen 2020 - 2023 paraqitet si me poshte (000/leke):

Emertimi	Fakt 2020	Fakt 2021	I prËtshem 2022	Plan 2023
Ardh:Tatimore	491,247	569,445	689,508	792,450
Ardh.Jo.tatim	248,452	665,288	480,521	631,635
Te trasheguara	83,428	85,504	198,614	
Totali	823,127	1,320,237	1,368,643	1,424,085

Bazuar ne VKB nr. 79, datë 02.12.2021 "Për disa ndryshime në V.K.B-së Nr.88, datë 24 .12.2020 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë", të prËtshmin e realizimit të buxhetit për vitin 2022, miratuar më V.K.B-në nr 4, datë 31.01.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2022", të dhënat që disponon drejtoria në sistemin TAIS mbi: numrin e bizneseve aktiv që kanë ushtruar veprimtari tregëtare në tërritorin e bashkisë Vlorë; mbi pagesat e kryera nga bizneset përgjatë vitit 2022 për zërat e taksave dhe tarifave, ka planifikuar të ardhurat për project – buxhetin e vitit 2023 për pjesën e të ardhurave që ndjek kjo drejtori, duke përfshirë edhe Agjentin Tatimor sh.a Ujësjiellës Kanalizime I cili faturon dhe arkëton taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit për kategorinë familje, por edhe taksën e tokës bujqësore taksë e cila ndiqet nga Njësitë Administrative dhe punojësit e DAV-së në cdo njësi.

Konkretisht, më poshtë paraqesim të ardhurat për project buxhetin e vitit 2023, të ardhura që ndiqen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale, për drejtoritë qe ndjekin të ardhurat për planifikimin dhe realizimin e buxhetit të bashkisë Vlorë.

Gjatë vitit fiskal 2022 Drejtoria e të Ardhurave Vendore sipas të dhënave të sistemit TAIS, në lidhje me numrin e subjekteve të regjistruara aktive, mbi të cilin janë llogaritur edhe planifikimi i të ardhurave për kategorinë "biznes", është si më poshtë:

Tabela 1.

NR	Bashkia Vlore	Subjekte	Subjekte	Subjekte	Subjekte	Subjekte
		2019	2020	2021	2022	2023
1	TP sh. pakice	2734	2782	2766	2787	2161
2	TP sh. shumice	191	207	206	43	39
3	TP sherbim	866	910	899	1454	2318
4	TP p.lira	302	314	364	258	310

5	TP BM ad.kryesore	572	551	601	747	809
6	TP BM ad.dytesore	490	496	488	355	278
7	T.P prodhim				198	229
8	OJF				38	46
	TOTALI	5155	5260	5324	5880	6190


Sikurse vihet re nga viti 2022 për planifikimin e të ardhurave për vitin 2023 kemi një numër biznesesh prej 6190 biznese, pra të shtuar 310 biznese.

Bashkia e Vlorës për vitin 2023, do të aplikojë taksat dhe tarifat për subjektet e mëposhtme për cdo Rajon dhe Njësi Administrative:

Tabela 2.

NR	Bashkia Vlore	Qyteti Vlore	Nj. A Orikum	Nj. A Novosele	Nj. A Shushice	Nj. A Qender	Totali
1	TP Tregeti	1847	197	67	23	66	2200
2	TP prodhim etj.	146	23	26	12	22	229
3	TP Sherbim	2237	46	16	2	17	2318
4	TP p.lira	307	1	2	0	0	310
5	TP BM ad.Kryesore	617	71	69	7	45	809
6	TP BM ad dytesore	251	11	8	1	7	278
7	OJF	42	3	0	0	1	46
	Totali	5447	352	188	45	158	6190

Numri I njësive të biznesit sipas regjistrimit të adresës kryesore në Njesitë Administrative përkatëse.



Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregtar, të ndarë sipas aktivitetit që kryejnë në Qytetin e Vlorës sipas rajoneve.

Tabela 3.

NR	Bashkia Vlore	Rajoni 1	Rajoni 2	Rajoni 3	Rajoni 4	Rajoni 5	Totali
1	TP Tregeti	149	391	698	254	355	1847

2	TP prodhim etj.	13	30	30	38	35	146
3	TP Sherbim	154	454	506	248	255	1617
4	TP p. iira	89	84	88	18	28	307
5	TP BM ad.Kryesore	53	112	224	95	133	617
6	TP BM ad dytesore	14	44	91	44	58	251
7	Transport	0	0	0	0	0	620
8	OJF	2	8	26	2	4	42
	Totali	474	1123	1663	699	868	5447

Drejtoria e të Ardhurave Vendore për projekt buxhetin e vitit 2023 planifikon taksat si më poshtë:

II.2. TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

1. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Ligji nr. 181, datë 28/12/2013 botuar në fletoren zyrtare nr.203, dt. 30/12/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt. 30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar".

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 106/2017 "Për disa Ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ka pasur një seri me ndryshime në strukturën e të ardhurave nga taksa e pasurisë së paluajtshme.

Baza e taksës

Për kategorinë "biznes" janë të dhënat e subjekteve për taksën e ndërtesës, në sipërfaqen e ndërtesës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike.

Për kategorinë e Ndertesave të Banimit informacioni sigurohet nga baza e të dhënave të Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime, Gjendjes Civile dhe vetë deklaratimit të familjarëve.

1.1 Takse Pasurie e Paluajtshme Ndërtesa

1.1.1 Kategoria e Familjarëve

Taksa e Pasurisë së Paluajtshme për këtë kategori është përlllogaritur nga Agjenti Tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime në bazë të numrit të familjeve që faturohen sipas kontratave të lidhura nga institucioni dhe familjeve si dhe numrit të familjeve të marra nga Gjendja Civile, ku kanë rezultuar për vitin 2021, 66708 familje. Nga numri total i familjeve janë përjashtuar nga pagesa e taksës së ndërtesës 4360 familje sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social dhe 8793 familje me kryefamiljarë pensionistë, sipas të dhënave të dhëna nga Sigurimet Shoqërore, Dega Vlorë.

Për vitin 2023 numri I familjeve që planifikohen për taksën e ndërtesës është 53555 familje, ku planifikimi për vitin 2023, sipas nivelit të taksës për cdo njësi administrative është sipas tabelës së mëposhtme:

Njesite administrative	Planifikimi per vitin 2023 taksa e nderteses					I pritshmi i vitit 2022
	Nr i familje sipas Gj.Civile vitin 2021	Nr. Familjeve të përjashtuar nga pagesa e taksës	Nr i familjeve qe planifikohen per vitin 2023	Tarifa per taksen e nderteses sipas VKB	Vlera e taksës se nderteses viti 2023	
Vlore	49769	11096	38673	3100	119,886,300	122,740
Novosele	3720	490	3230	1500	4,845,000	
Shushice	4928	130	4798	1500	7,197,000	
Qender	5317	237	5080	1500	7,620,000	
Orikum qytet	1774	520	1254	1500	1,881,000	
Orikum rural	1200	680	520	2200	1,144,000	
	66708	13153	53555		142,573,300	

Në lidhje me taksën e ndërtesës për kategorinë familje vihet re se për planifikimin në buxhet për vitin 2023, duhet bërë një rishikim i këtyre taksave, pasi në bazë të të dhënave për tre vitet e fundit është parë se këto taksa nuk realizohen në raport me planifikimin vjetor.

Më poshtë po paraqesim situatën e planifikimit dhe arkëtimit të këtyre taksave dhe tarifës së pastrimit në tre vitet e fundit:

(000/lekë)

Vitet	2020			2021			I pritshmi 2022			Planifikimi v.2023
	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	
Taksa e ndërtesës për kategorinë familje nga U.K sh.a	137,002	55,665	41	144,480	110,538	77	145,372	122,740	84	142.573

Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5- Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore, Në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime, pika a) - Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme, nisur nga të dhënat e mësipërme, për vitin 2023, duhet të planifikohen në buxhet taksat dhe tarifat të cilat janë të mundshme për tu mbledhur. Përsa kohë sh.a Ujësjetllës Kanalizime nuk mbulon gjithë territorin e bashkisë Vlorë me matësa (sahat uji) në cdo familje, një pjesë e konsiderueshme e këtyre të ardhurave mbeten pa u arkëtuar duke u bazuar në familjet e dhëna nga Gjendja Civile.

1.1.2 Kategoria e Ndërtesa të tjera (biznesi)

Sipas të dhënave të sistemit TAIS rezulton se për vitin 2022 janë të regjistruar për taksën e ndërtesës **5068 subjekte taksapaguese**, numër biznesesh të cilët së bashku me të pritshmin e vitit 2022, do të shërbejnë për planifikimin e buxhetit për vitin 2023.

Kjo taksë për specifikën e saj, është shumë e lidhur me ndertimet e reja në qytetin e Vlores të pa hipotekuara si dhe ndryshimin e destinacionit të përdorimit që i bëhet pronave për të dhënë me qira në shërbim të aktiviteteve ekonomike. Të ardhurat e planifikuara për këto kategori do të jenë në vlerën 107.625 mijë lekë sipas koeficientit dhe vlerës për çdo njësi administrative:

Njësia		Vlore		Novoselë		Shushicë		Qëndër		Orikum Qytet		Orikum (Rurale)	
Cmimi referues për m2		61800		61800		61800		61800		60000		60000	
Shkalla e taksës sipas VKM 132/2018		100%		65%		65%		65%		100%		67%	
Shkalla e taksës sipas ligjit 68/2017		100%		70%		70%		70%		70%		70%	
Qëllimi i përdorimit të pronës	Koeficient	Vlera	M2	Vlera	M2	Vlera	M2	Vlera	M2	Vlera	M2	Vlera	M2
njësia tregëtimi dhe shërbimi	150%	185.4	512,701.00	84.36	36,528.00	84.36	3,816.80	84.36	29,309.15	126	26,100.00	84.36	45,000.00
Per parkim të mbuluar dhe bodrumet	70%	86.52	3,818.00	39.37	7,446.00	39.37	280	39.37	710.00	58.8	0	39.37	4,233.12
Per parkim të hapur	30%	37.08	8500	16.87	10,976.00	16.87	0	16.87	6,800.00	25.2	0	16.87	0
Per veprimtari industriale	50%	61.8	115,000.00	28.12	33,116.00	28.12	380	28.12	11,368.22	42	1260	28.12	3,231.30
Per veprimtari dhe blegtori	30%	37.08	515.5	16.87	900	16.87		16.87		25.2	0	16.87	0
TOTALI		107,624,999	94,664,192		3,081,502		321,985		2,472,519		3,288,600		3,796,200

Element vlerësimi për taksën e ndërtesës është vlera 250.198 mijë lekë si më poshtë:

- Për kategorinë familje sipas të dhënave të sh.a Ujësjetllës Kanalizime 142.573 mijë lekë
- Për kategorinë biznes sipas të dhënave në sistemin TAIS në vlerën 107.625 mijë lekë

1.2 Kategoria e Taksës mbi tokën bujqësore

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore është bërë në bazë të informacionit të dhënë nga njësitë administrative sipas të dhënave që disponojnë nga regjistrat e DAMT-së.

Ekonomia		Kategoria	Lekë/ha në vit	Sip./ha	Vlefëta
Bashkia Vlorë	Ish N.B Ullishte	VII	1800	340	612,000
	Ish N.B Rinia	III	3600	94	338,400
Totali B.Vlorë					950,400
Nj.A.Novoselë	Fitore	IV	3200	409	1,308,800
	Akërnj	VIII	1800	724	1,303,200
	Novoselë	V	3000	586	1,758,000
	Aliban	V	3000	300	900,000
	Mifol	V	3000	257	771,000
	Bishan	IV	3200	571	1,827,200
	Poro	V	3000	465	1,395,000
	Delisuf	VI	2400	370	888,000
Dellenje	VI	2400	263	631,200	

	Trevllazër	VI	2400	613	1,471,200
	Cerkovinë	VI	2400	217	520,800
	Skrofotinë	VI	2400	187	448,800
Totali Nj.A.Novoselë sipas Shkresës së datës 02.11.2022					13,223,200
Nj.A.Orikum	Dukat+Dukat Fushë	VI	2400	1197	2,872,800
	Tragjas	VI	2400	490	1,176,000
	Orikum	III	3600	363	1,306,800
	Radhimë	III	3600	357	1,285,200
	Jonufër 2	III	3600	0	0
Totali Nj.A.Orikum sipas Shkresës nr.1151, dt.02.11.2022					6,640,800
Nj.A.Qendër	Babicë e Madhe	VI	2400	681	1,634,400
	Babicë e Vogël	VI	2400	150	360,000
	Xhuherinë	VI	2400	194	465,600
	Kaninë	V	3000	683.5	2,050,500
	Kërkovë	VI	2400	257.3	617,520
	Zvërnec	VI	2400	240.78	577,872
	Sherishtë	V	3000	333	999,000
	Panaja	VI	2400	257.29	617,496
	Hoshtimë	VI	2400	354.7	851,280
	Nartë	VI	2400	634.66	1,523,184
Bestrovë	VII	1800	348.91	628,038	
Totali Nj.A.Qendër sipas Shkresës se dates 02.11.2022. Per vitin 2023 ne fshatin Kanine jane zbritur 15.6 ha, te cilat preken nga projekti Landfilli dhe By pass					10,324,890
Nj.A.Shushicë	Risili	IV	3200	359	1,148,800
	Bunavi	IV	3200	135	432,000
	Çeprat	IV	3200	147	470,400
	Llakatund	IV	3200	397	1,270,400
	Shushicë	IV	3200	332	1,062,400
	Grabian	IV	3200	166	531,200
	Drithas	IV	3200	295	944,000
	Mekat	IV	3200	338	1,081,600
Beshisht	IV	3200	206	659,200	
Totali Nj.A.Shushicë					7,600,000
TOTALI BASHKIA VLORE					38,739,290

Element vlerësimi për taksën e ndërtesës është vlera 38.739 mijë lekë.

2. Taksa mbi truallin

Llogaritja e kësaj takse për vitin 2023 është bërë duke u nisur nga regjistrimet faktike që kanë bërë inspektorët në terren dhe informacionit nga sistemi TAIS në lidhje me vlerësimin tatimor për zërin truall. Shuma e arketuar për vitin 2022 pritet të jetë në vlerën 11.000 mijë leke.

Nr.	Emertimi	Vlera e takses ne leke m2/vit per qellime banimi nga individet	Vlera e takses ne leke m2/vit per qellime biznesi
1	Takse trualli (lekë/m2)	0.56	20
2	Siperfaqja (m2)	34,060.85	619,973.00
	Total (Lekë)	19,074.08	12,399,460.00
Shuma totale (Lekë)			12,418,534.08

Element vleresimi per planifikim eshte shuma 12.418 mijë lekë

3. Taksa e Fjetjes ne Hotel

Në total numri i dhomave sipas evidentimeve të bëra në terren për vitin 2023 parashikohen 3016 duke përfshirë edhe hotelet të cilat kanë deklaruar me regjistër . Taksa e fjetjes ne hotel do te kete si baze llogaritje cdo nate fjetje per dhome dhe kategorizohet ne disa nivele te ndryshme, ne perputhje me kategorizimin e bashkive dhe llojin e njesive akomoduese, sipas Aneksit 8, pjese e ketij raportit, si me poshte:

- Hotel me 4-5 yje: 175 leke per nate fjetje;
- Bujtine, fjetine, motel dhe cdo njesi tjeter akomoduese, sipas percaktimeve te ligjit per turizmin;, 70 leke per nate fjetje, ne varesi te zones ku ndodhen.

Planifikimi i taksës së hotelit për vitin 2023 është bërë në bazë të të dhënave të gjeneruara nga sistemi TAIS dhe ndarjes sipas zonave dhe niveleve të përcaktuara në vendimin e paketës fiskale. Vlerësimi tatimor për subjektet të cilët kanë aktivitet hoteleri/turizëm parashikohet te jete si me poshtë:

Nr.	Klasifikimi sipas takses se fjetjes ne hotel	Nr. Dhoma	Koeficient shfrytezimi	Cmimi sipas VKB	Vlera
1	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese pergjate Zones A (Zona Uji I Ftohte -Radhime- Orikum)	85	120 dite/vit	175	1,785,000
		810	120 dite/vit	70	6,804,000
		646	90 dite/vit	70	4,069,800
		498	60 dite/vit	70	2,091,600
2	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese pergjate Zones B (Zona Plazhi I Vjeter -Zver nec)	77	90 dite/vit	70	485,100
		85	70 dite/vit	70	416,500
		421	45 dite/vit	70	1,326,150
3	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese pergjate Zones C (Cdo zone qe nuk perfshihet ne zonen Adhe B)	138	100 dite/vit	70	966,000
		115	70 dite/vit	70	563,500
		141	60 dite/vit	70	592,200
4	Të ardhura totale (1+2+3)	3016			19,099,850
5	Me regjistër	21937	me regjister	70	1,535,590
	Vlera totale e takses se fjetjes ne hotel per vitin 2023				20,635,440

Element vleresimi per planifikim eshte shuma 20.635 mijë lekë .

4. Taksë table dhe reklame

Duke u nisur nga regjistrimet në terren nga inspektorët, të dhënave të sistemit TAIS dhe nivelit të taksës sipas VKB Nr.79 date 02.12. 2021 “Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne territorin e bashkise Vlorë”, planifikimi per vitin 2023 jepet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Lloji i tabelës	Nj/matese	Taksa	M2	Vlera
I.	Takse tabelle për qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të treta (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	Deri në 2 m²	Leke/m²/vit	0		
Mbi 2 m² deri në 10 m²					
b	E thjeshtë (pa ndricim)	Leke/m ² /vit	10000	270	2,700,000.00
	Me ndricim të thjeshtë	Leke/m ² /vit	15000	210.9	3,163,500.00
	Elektronike	Leke/m ² /vit	20000	14.1	282,000.00
Mbi 10m² deri në 20m²					
c	E thjeshtë (pa ndricim)	Leke/m ² /vit	8500		
	Me ndricim të thjeshtë	Leke/m ² /vit	12750		
	Elektronike	Leke/m ² /vit	17000		
Mbi 20m² deri në 40m²					
ç	E thjeshtë (pa ndricim)	Leke/m ² /vit	5500		
	Me ndricim të thjeshtë	Leke/m ² /vit	8250		
	Elektronike	Leke/m ² /vit	11000		
Mbi 40m²					
d	E thjeshtë (pa ndricim)	Leke/m ² /vit	4000		
	Me ndricim të thjeshtë	Leke/m ² /vit	6000		
	Elektronike	Leke/m ² /vit	8000		

II	Tabela per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim				
	Tabele identifikuese		120		
III	Tabela per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme deri ne tavanin maksimal 35m2				
	E thjeshte	Leke/m2/vit	22500	280	6,300,000.00
	Elektronike	Leke/m2/vit	45000	35	1,575,000.00
IV	Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaire, stenda, rekiamuese, banderola, etj.				
	Te te gjitha llojeve dhe permasave	Leke/m2/dite	1,000		
Totali					14,020,500.00

Element vleresimi per planifikim eshte shuma 14.020 mijë lekë .

5. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

5.1 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit).

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Llogaritjet kryhen bazuar VKM nr. 168, date 27.03.2019 “Për metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme...”

Nr.	Emërtimi	M2	Koeficient	Cmimi i shitblerjes	Vlera të ardhura
1	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit				
1.1	Për zonën nga Skela deri tek Rrapi (vija e parë) sipas hartës bashkëli dhur.	5,592	8	61,800	27,651
1.2	Për zonat e tjera në qytetin e Vlorës, fshati Kaninë, fshati Zvërnec, njësia Orikum (përveç pikës 1.1 dhe 1.6).	789,845	4	61,800	195,302
1.3	Njësia Qëndër (me përjashtim të fshatit Kaninë, Zvërnec		4	43,260	-

1.4	Njësia Shushicë	-	4	40,170	-
1.5	Njësia Novoselë	-	4	43,260	-
1.6	Njësia Orikum: fshatrat Dukat, Dukat i Ri, Tragjas, Radhimë, sipas hartës bashkëlidhur.	17,120	4	42,000	28,761
1.7	Rigjenerim i zonave në pallatet e vjetra të ndërtuara para vitit 1993, (ku përfshihet prishja e pallateve të vjetra, dhe ndërtimi sipas PPV në fuqi)	1,359	4	43,260	2,351
2	Për ndërtime për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, përdorim publik.	35,650	3	32,516	34,780
3	Njësi banimi një familjare kur investitori është vetë familjari, Qyteti Vlorë,	5,350	3	32,516	5,290
3.1	Njësi banimi një familjare kur investitori është vetë familjari, zonat e tjera përveç sa specifikuar në pikën 3	2,119	2	32,516	1,378
4	Ndërtesa në proces legalizimi	207,713	0.5	32,516	33,769
5	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.		0.1	32,516	-
6	Për projektet e infrastrukturës për ndërtim në zonën industriale	9,801	1	32,516	3,190
7	Për Ndërtimet me deklarate paraprake punimesh	1,755	3	32,516	1,712
				Totali	319,684

Parashikimi i të ardhurave nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukture nga ndërtimet e reja për vitin fiskal 2023 është **319,684,000 lekë**.

6. Taksa e Mjeteve të përdorura.

Ne zbatim të Ligjit Nr.10458 dt.21.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.9975, dt.28.07.2008 ”Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 25, ku 25% e të ardhurave vjetore të “Taksës Vjetore të Mjeteve të Përdorura” i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore nga 1 Janari 2018.

Vlera e pritshme për arkëtim nga kjo taksë, për vitin 2022 është në shumën **77,600 mije lekë**, kundrejt një planifikimi prej **75,600 mije lekë**.

Për vitin fiskal 2023 është parashikuar që të arkëtohet për llogari të Bashkisë Vlorë shuma **83,400 mije lekë**, sipas konfirmimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor me shkresën Nr. 8440/1 Prot, datë 11.11.2022.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 83,400 lekë

7. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Për vitin fiskal 2022, me shkresën Nr. 7989/1 prot, datë 27.10.2022, te Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë parashikohet që vlera e pritur për tu arkëtuar për vitin 2022, të jetë në shumën 2,640 mijë leke përkundrejt planifikimit prej 18,000 mijë lekë

Llogaritja e Tatimit të thjeshtuar të fitimit të biznesit të vogël për vitin fiskal 2023 është përlllogaritur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, e cila për llogaritjet e të ardhurave të këtij viti është bazuar në xhiron e deklaruar për vitin 2022, Në zbatim të ligjit 106/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 2 për ato biznese që në deklaratën tyre kanë xhiron mbi 14 milionë lekë. Për vitin 2023 parashikohet se do të ketë një arkëtim në rreth 4,500 mijë leke sipas shkresës Nr. 7989/1 prot, datë 27.10.2022.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 4,500 mijë lekë.

8. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Vlorë e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

Në bazë të tregueseve nga ASHK Vlorë vlera e pritshme për arkëtim nga kjo taksë për vitin 2022 është në shumën 31,000 **mijë lekë**, kundrejt një planifikimi prej **30 000 mijë lekë**. Për vitin 2023 pritet të arketohet shuma prej 31 000 mijë lekë.

Ky tregues ndiqet rregullisht nga strukturat e DFBK, punë e cila reflektohet në akt - rakordimet mujore me këtë agjent dhe që konfirmohet edhe nga Dega e Thesarit.

Administrata e bashkisë është drejtuar ASHK-së Vlorë me shkresën Nr. 11936 prot, datë 20.10.2022 “Kërkesë për depozitimin e planit të të ardhurave të arkëtuara nga institucioni juaj për vitin 2023”, e cila nuk është përgjigjur.

Në këto kushte Administrata e Bashkisë vlerëson që në planifikim e të ardhura në Planifikimin e Buxhtit 2023 për taksën e kalimit të pronësisë të psurive të paluajtshme të marrë parasysh parashikimin e pritshëm të realizimit të saj për vitin 2022 në shumën 31.000 mijë lekë.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 31 000 mijë lekë.

9. Taksa mbi të Ardhurat Personale

Bazuar në ligjin nr. 68/2017 date 27.04.2017 për Financat e Vetëqeverisjes Vendore neni 25 pika ç, mbi 2% të Tatimit mbi të Ardhurat Personale, si dhe shkresa nr.7414/1 date 26.10.2021 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Vlore në të cilën theksohet se TAP-i bazohet në numrin e

popullsise se bashkive perkatese dhe llogaritet nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve. Duke marre parasysh realizimin e vitit 2022 i cili është 14,488,247 lekë për TAP-in nga Drejtoria e Pergjithshme për vitin 2023 planifikohet shuma prej 15,000,000 leke.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 15 000 000 leke

10. Takse parkimi

Sipas V.K.B Nr.79 , datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, parkimi me pagese për vendet e rezervuara është 19,000 leke ne vit. Ne baze te kërkesave te paraqitura nga subjektet private planifikohen 80 vende parkimi me pagese për vitin 2022.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 1,520,000 lekë.

II.2 TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha te ardhurat me natyre jo tatimore, qe rezultojne nga ofrimi i shërbimeve publike, te drejtat e perdorimit te pronave publike dhe vendore dhe debia sipas subjekteve debitorë.

Me poshte po japim planifikimin sipas zerave te ketij grupi te ardhurash qe ndjek Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

1.Tarifa për zënien e hapësirave publike

Baza e tarifës për zenien e hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte apo individë (shitësit ambulantë) për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

1.1 Tarifa për zënien e hapësirës publike përbëhet prej:

Nr	Emertimi	Tarifa leke/m ² ne muaj	Siperfaqja m ²	Totali
1	Per zenien e hapësirave publike ne Bulevardin Vlore Skele (duke përfshire te dyja anet e tortuarit), pëdonalia e sheshit Pavaresia Skele (ne te dyja anet)			
	Per perdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve te terrenit	400	620	1,491,600.00
	Per perdorimin e hapësirës publike per 12 muaj	300	2,091	8,482,600.00

Per zenien e hapësirave publike ne zonen e Lungomares				
2	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	300	8,674	29,650,923.00
	Per perdorimin e hapësires publike sipas akt kontrolleve te terrenit	500	4,963	6,908,900.00
Per zenien e hapësirave publike ne zonen e qendres Historike				
3	Per perdorimin e hapësires publike per 12 muaj	200	608	1,459,200.00
	Per perdorimin e hapësires publike sipas akt kontrolleve te terrenit	300	448	842,400.00
4	Per zenien e hapësirave publike per zonat e tjera pervec pikes 1,2 dhe 3	200	10,345	7,544,285.00
5	Subjektet tregëtarë që ushtrojnë veprimtari në tregjet publike të miratuara dhe tregëtarët ambulant	50/100		1,783,545.00
Total				58,163,453.00

Element vlerësimi per planifikim eshte shuma 58.163 mijë lekë.

1.2 Zënia e hapësirave publike për stacione plazhi është parashikuar në shumën 36.000 mije leke. Kjo shumë është e përafërt me realizimin e vitit 2022.

Nderkohë nuk parashikohet rritje e te ardhurave nga kjo tarifë pasi me ndryshimin e legjislacionit është parashikuar të ulet sipërfaqja në përdorim të biznesve ne 70 % duke rritur sipërfaqen për përdorim publik ne 30%.

Element vlerësimi për planifikim (1.1 + 1.2) është shuma 94,163 mije lekë.

2. Tarifa e shërbimit te ndricimit, pastrimit dhe gjelberimit

Tarifa, paguhet nga te gjithe familjet, personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, qe banojne ose ushtrojne veprimtari ekonomike brenda territorit te Bashkise Vlore. Kjo tarife eshte vjetore dhe likujdimi i saj detyrimisht behet brenda 20 Prillit te vitit buxhetor ose sipas afateve të përcaktuara në V,K,B në bazë të momentit të rregjistrimit të biznesit.

Per subjektet tatimpagues me xhiro 0 – 8 milion leke ne vit.

NR	Kategoria	Niveli I tarifës ne vit	Numri I subjekteve	Vlera ne lek
1	Tatimpagues te grupit " shitje me pakicë"			

1.1	Njesite tregtare te veshjeve, modes luksit (butike),parfumeri e te ngjashme me to.	10,000	210	2,100,000.00
1.2	Njesite tregtare si bizhuteri, argjendari te florirt e metale te cmuara e te ngjashme me to	10,000	23	230,000.00
			233	
1.3	Njesi te ushqimit social, restaurant, piceri, fast food, bare disko, kafe, pub, internet pergjate Bulevardit Vlore-Skele, Skele -Lungomare, Jonufer -Radhime-Orikum-Llogora, Vija e plazhit te vjeter-Zver nec			
a.	Siperfaqe ndertimi deri ne 100 m2	20,000	238	4,760,000.00
b.	Siperfaqe ndertimi mbi 100 m2	25,000	153	3,825,000.00
			391	
1.4	Per njesi te ushqimit social, restaurant, piceri, fast food, bare disko, kafe, pub, internet qe perfshihen ne zona te tjera niveli I tarifes do te jete 50 % e tarifës në pikën a, b			
a.	Siperfaqe ndertimi deri ne 100 m2	10,000	480	4,800,000.00
b.	Siperfaqe ndertimi mbi 100 m2	12,500	104	1,300,000.00
1.5	Njesi shitje librari, kancelari, lojera femijesh e artikuj te perdorur dhe te ngjashme me to.	6,000	70	420,000.00
1.6	Per njesi te ushqimore, artikuj te perzier te karakterit ushqimor dhe te ngjashme me to.	10,000	798	7,980,000.00
1.7	Njesi tregetare mish, peshk, bulmet.	10,000	85	850,000.00
2	Tatimpagues te grupit " shitje me shumice"	18,000	39	702,000.00
			1576	
3	Tatimpagues te grupit " prodhime dhe tregetim			
3.1	Perpunim druri, metali, tapiceri e te ngjashme me to.	12,000	86	1,032,000.00
3.1	Perpunim tulla, tjegulla, blloqe, furra, gelqere e te ngjashme me to.	12,000	25	300,000.00
3.1	Te karakterit ushqimor, piceri, prodhim buke, mishi, peshku, bulmeti.	12,000	118	1,416,000.00
			229	
4	Tatimpagues te grupit " sherbime"			
4.1	Riparim artikuj elektroshtepike, radio tv, paisje fonie e te ngjashme me to.	6,000	67	402,000.00
4.2	Kepucar, galanteri, parukeri, berber.	6,000	202	1,212,000.00

4.3	Marangoz, elektrikist, murator, elektroout e te ngjashme me to.	6,000	92	552,000.00
4.4	Per profesione te lira si avokat, noter, ekspert kontabel, mjek, mesues, topograf te ngjashme me to.	10,000	310	3,100,000.00
4.5	Per autoshkolla, kurse profesionale dhe te ngjashme me to.	10,000	152	1,520,000.00
4.6	Agjensi doganore, kembim valutor, agjensi turistike dhe te ngjashme me to.	10,000	221	2,210,000.00
4.7	Per pikat e sherbimit te makinave (auto servis), lavanteri, lavazho, pastrim kimik,sherbim te rojeve civile e te ngjashme me to.	10,000	255	2,550,000.00
4.8	Sherbime Komplekse, sherbiome on line, sherbime kompjuterike	10,000	281	2,810,000.00
4.9	Per sallat e lojerve sportive aerobi, kalceto, palestra dhe te ngjashme me to.	8,000	27	216,000.00
			1607	
5	Per institucionet jopublike si shkolla, kopsht, cerdhe e te ngjashme me to.			
a.	Deri ne 10 klasa	10,000	14	140,000.00
b.	Mbi 10 klasa	15,000	2	30,000.00
6	Per laboratore dentare, klinike dhe laborator diagnostikues e kimik, farmaci e te ngjashme me to.	20,000	142	2,840,000.00
7	Per motele, hotele , komplekse turistike	1,000	243	243,000.00
8	Per subjektet me aktivitet Fondacione, OJF e te ngjshme me to	5,000	46	230,000.00
			447	
Total			4483	47,770,000.00

- Për subjektet tatimpagues me xhiro 0-8 milion lekë në vit – 47.770 mijë lekë

b. Tarifa e sherbimit per ndricim, pastrim e gjelberim per subjektet qe ushtrojne aktivitet ne transportin e mallrave e pasagjereve eshte sipas tabelës se mëposhtme :

Nr.	Emertimi	Niveli i tarifes	Nr. subjekte ve	Vlefte ne leke
	Transport pasagjeresh			

1	Automjete deri ne 9 vende	4.000 leke/vit	138	552,000.00
2	Automjete 10-42 vende	8.000 leke/vit	97	776,000.00
3	Automjete mbi 42 vende	12.000 leke/vit	26	312,000.00
	Totali (Transport Pasagjeresh)		261	1,640,000.00
	Transport mallrash			
4	Automjete deri ne 5 ton	4.000 leke/vit	161	644,000.00
5	Automjete 5-16 ton	8.000 leke/vit	57	456,000.00
6	Automjete mbi 16 ton	12.000 leke/vit	61	732,000.00
	Totali (Transport Mallrash)		279	1,832,000.00
	Transport uxor			
7	Mjete lundruese 0 m-5 m	4.000 leke/vit	22	88,000.00
	Mjete lundruese 5.01 m-10 m	8.000 leke/vit	20	160,000.00
8	Mjete lundruese mbi 10 m	15.000 leke/vit	38	570,000.00
	Totali (Transport Uxor)		80	818,000.00
	TOTALI		620	4,290,000.00

- Për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave dhe pasagjerëve – 4.290 mijë lekë

c. Për subjektet tatim pagues mbi 8 milion lekë në vit.

Të dhënat për këtë kategori biznesesh janë sipas gjenerimin të raporteve të sistemit TAIS në bazë të të dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve cdo fillim viti.

Nr.	Emërtimi	Niveli I tarifës në vit (lekë)	Nr. Subjektsh Adresa kryesore	Nr. Subjektsh Adresa sekondare	Vlera ne lek
1	Për subjektet me aktivitet tregtar, e sherbime për vendodhjen kryesore				
1.1	Per subjektet me qarkullim deri ne 20 milion leke	25,000	95	21	2,637,500.00

1.2	Per subjektet me qarkullim mbi 20 milion leke	40,000	160	41	7,220,000.00
1.3	Per subjektet me qarkullim mbi 50 milion leke	70,000	78	34	6,650,000.00
1.4	Per subjektet me qarkullim mbi 100 milion leke	100,000	109	125	14,057,600.00
Total 1			442	221	30,565,100.00
2	Për subjektet me aktivitet prodhim, e shërbime për vendodhjen kryesore				
2.1	Per subjektet me qarkullim deri ne 20 milion leke	20,000	167	27	3,610,000.00
2.2	Per subjektet me qarkullim mbi 20 milion leke	40,000	18	1	740,000.00
2.3	Per subjektet me qarkullim mbi 50 milion leke	60,000	17	2	1,080,000.00
2.4	Per subjektet me qarkullim mbi 100 milion leke	80,000	8	2	720,000.00
2.5	Për subjektet e lojërave të fatit të vendodura në hotele me 5 yje	400,000	0	1	200,000
Total 2			210	33	6,350,000.00
3	Për subjektet me aktivitet: Profesione te lira, për vendodhjen kryesore.	15,000	11	0	165,000.00
4	Për subjektet e ndërtimit që kanë selinë me adresë jashtë kantierit të ndërtimit mbga adresa ku ushtron aktivitet	30,000	60		1,800,000.00
4.1	Për subjektet me aktivitet ndërtim që kanë kantier ndërtimi për adresën kryesore	100,000	64	20	7,400,000.00

4.2	Për subjektet që kryejnë shërbime të kontraktuara dhe ju është miratuar leje për riaprimë, merimetime, lyerje dhe të ngjashme me to.	15,000	26	0	600,000.00
Total			161	20	9,965,000.00

	Totali 1+2+3+4		813	274	46,880,100.00
--	-----------------------	--	------------	------------	----------------------

- Për subjektet tatimpagues mbi 8 milion lekë në vit - 46.880 mijë lekë

d. Tarifë pastrimi në tregjet publike

Duke u nisur nga të dhënat e regjistruara në regjistrat e sektorit të tregjeve për subjektet që operojnë në treg në vitin 2022 (Novosele, Tregu i Postes së Çoles dhe Qendra), ku janë rreth 306 tregtarë është hartuar pasqyra e mëposhtme:

Lloji i aktivitetit	Nr. kontratave të lidhura	Taksa/m ²	Plani i të ardhurave mujore	Plani i të ardhurave viti 2023
Tarifë pastrimi në tregjet e qytetit	306	1200	367.200	4.406.400
TOTALI				4.406.000

Numri I tregëtarëve ka zbritje pasi janë hequr tregëtarët ambulant tek Tregu i Coles, i cili ka kaluar në administrim të pronarëve të truallit ku shtrihet hapësira e tij, kjo sipas përcaktimeve të miratuara me Vendime të Këshillit të Bashkisë Vlorë. Gjithashtu nga kjo listë janë hequr edhe tregëtarët e Tregut të Orizit të cilët ushtronin aktivitet tek Sahati në qendër dhe mbas largimit të tyre nga kjo zonë , për vitin 2022 nuk ushtronin aktivitet, por vetëm një pjesë e tyre janë sistemuar në tregun mbas postës në qendër të qytetit.

d. Për familjet

Tarifa e pastrimit, ndricimit, gjelbërimit për këtë kategori është perlogaritur nga Agjenti Tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime ku të dhënat e dërguara nga ky institucion janë sipas tabelës së mëposhtme:

Njesite administrative	Planifikimi për vitin 2023 tarifa pastrim, ndricim, gjelberim					I pritshmi i vitit 2022

	Nr I familje sipas Gj.Civile vitin 2021	Nr. Kontratave pejashtuar nga taksat	Nr i familjeve qe planifikohe n per vitin 2023	Tarifa per pastrim, ndricim, gjelberim sipas VKB	Vlera e takses se ndertesese viti 2023	
Vlore	49769	11096	38673	3400	131,488,200	
Novosele	3720	490	3230	1200	3,876,000	
Shushice	4928	130	4798	1200	5,757,600	
Qender	5317	237	5080	1200	6,096,000	
Orikum qytet	1774	520	1254	1200	1,504,800	
Orikum rural	1200	680	520	2400	1,248,000	
	66708	13153	53555		149,970,600	128,257

Sikurse ndodh për taksën e ndërtesës e njëjta situatë paraqitet edhe për tarifën e pastrimit për kategorinë familje. Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5- Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore, Në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime, pika a) - Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme, nisur nga të dhënat e mësipërme, për vitin 2023, duhet të planifikohen në buxhet taksat dhe tarifat të cilat janë të mundshme për tu mbledhur. Përsa kohë sh.a Ujësjellës Kanalizime nuk mbulon gjithë territorin e bashkisë Vlorë me matësa (sahat uji) në cdo familje, një pjesë e konsiderueshme e këtyre të ardhurave mbeten pa u arkëtuar duke u bazuar në familjet e dhëna nga Gjendja Civile.

Vitet	2020			2021			I pritshmi 2022			Planifikimi v.2023
	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	
Tarifa e pastrimit për kategorinë familje nga U.K sh.a	138,291	38,437	28	152,928	99,937	65	152,880	128,256	84	149.971

Element vleresimi per planifikim për kategorinë familje eshte shuma 149.971 mijë lekë.

e. Tarifa e pastrim , ndricim, gjelberimit për institucionet shtetërore.

Bashkia Vlorë me shkresën nr. 12613 prot., datë 03.11.2022 i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Tatimeve mbi numrin e institucioneve dhe numrin e të punësuarve në secilin prej tyre. Në bazë të informacionit të dërguar prej tyre tarifa e pastrim ndricim, gjelberimit për këtë kategori paraqitet si më poshtë vijon:

Emertimi	Tarifa e pastrim, ndricim, gjelberim viti 2023	Nr institucioneve	Vlera per v 2023
Per institucionet deri ne 5 punonjes	50,000	1	50,000
Per institucionet mbi 5 deri 20 punonjes	70,000	15	1,050,000
Per institucionet mbi 20 punonjes	100,000	25	2,500,000
			3,600,000

Element vleresimi per planifikim për kategorinë e institucioneve shtetërore është shuma 3.600 mijë lekë.

Element vleresimi per planifikim për tarifën e pastrim, ndricim, gjelbërim totale biznese, institucione shtetërore dhe familja është shuma 256.917 mijë lekë, e ndarë si më poshtë:

- Për subjektet tatimpagues me xhiro 0-8 milion lekë në vit – 47.770 mijë lekë
- Për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave dhe pasagjerëve – 4.290 mijë lekë
- Për subjektet tatimpagues mbi 8 milion lekë në vit - 46.880 mijë lekë
- Për subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregjet publike- 4.406 mijë lekë
- Për institucionet shtetërore – 3.600 mijë lekë
- Për familjet - 149.971 mijë lekë

Planifikimi për të ardhurat nga zëri i debisë.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori I Borxhit dhe Kontabilitetit, parashikon që për vitin 2023 të ardhurat nga zëri i debitorëve të jetë në vlerën 70.000 mijë lekë. Ky planifikim vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera për vitin 2022 dhe debitorët e krijuar në vitet e fundit.

Element vleresimi per planifikim për zerin e debise është shuma 70.000 mijë lekë.

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR PLANIFIKIMIN E PROJEKT BUXHETIT 2023 PËR TAKSAT DHE TARIFAT QË NDJEK DAV DHE AGJENTI TATIMOR sh.a UJËSJELLËS KANALIZIME, PARAQITET SI MË POSHTË:

Nr.	EMERTIMI	Planifikimi 2022	Sipas PBA-se 2023-2025	Planifikimi 2023	I pritshmi 2022
I	Te ardhura nga taksat vendore	331,604	334,059	336,011	234,000
1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa biznes	250,732	253,934	250,198	190,000
2	Takse trualli	12,371	8,822	12,419	11,500
3	Takse e fjetjes ne hotel	18,743	17,070	20,635	18,500
4	Takse table + reklame	11,000	17,865	14,020	14,000
5	Taksa e tokes bujqesore	38,758	36,368	38,739	13,500
II	Te ardhurat nga tarifate vendore	351,078	347,024	385,080	331,000
1	Tarife për zënien e hapësirave publike	50,794	45,181	58,163	58,000
2	Tarife tregu				

3	Tarife e zënies së hapësirave publike biznes				
4	Tarife vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim	235,284	236,843	256,917	195,000
6	Te ardhura nga zeri debi	65,000	65,000	70,000	78,000
III	TOTALI I TE ARDHURAVE (I + II)	682,682	681,083	721,091	565,000

3. Tarifa shërbimi për subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e ndërtimit

Planifikimi i këtyre të ardhurave është kryer si në rastin e të ardhurave nga Taksa e ndikimit në Infrastruktura.

Nr.	Emërtimi	Niveli i tarifës	Objekte	Vlera
1	Tarifa e aplikimit pranë sportelit të shërbimit të DPKZH	5000 lekë	300	1,500,000
2	Tarife për ndërtime të reja mur perimetral	10 lekë/m ²	800	8,000
3	Tarife shërbimi për vërtetim konfirmim dokumenti			
	-për dokument ligjor	200 lekë/copë	5,000	1,000,000
	-për dokument teknik	700 lekë/copë	7,500	5,250,000
10	Tarife shërbimi për kontrollin përfundimtar për objektet me deklarate paraprake dhe ndryshim funksioni/aktiviteti	5000 lekë	1,000	5,000,000
	Gjithsej			12,758,000

Nr.	Emërtimi	Niveli i tarifave për objekte private deri në 2 kate	Objekte	Vlera
1	Tarifa e aplikimit pranë sportelit të shërbimit të DPKZH	1000 lekë	1,000	1,000,000
2	Tarife për ndërtime të reja mur perimetra	10 lekë/m ²	600	6,000
5	Tarife shërbimi për vërtetim konfirmim dokumenti të dalë nga arkivi teknik i Urbanistikës			
	-për dokument ligjor	100 lekë/copë	1,000	100,000
	-për dokument teknik	500 lekë/copë	600	300,000
	TOTALI			1,406,000

Element vlerësimi për planifikim është shuma 14,164,000 lekë.

4. Tarifa e shërbimit veterinar

Në zbatim të ligjit nr. Ligjit nr. 71/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 54, shërbimi veterinar për të cilën me Vendim të Këshillit të Bashkisë miratohej tarifa veterinarë i ka kaluar Autoritet Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, ku deri në krijimin e strukturës së AKVMB do vazhdonin ta kryeanin si shërbim veterinerët e bashkisë. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 2.9.2020 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e

Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve” është krijuar struktura e organizimit dhe funksionimit të AKVMB.

Me vendimin nr. 475, datë 30.7.2021”Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar qartë detyrat që i mbeten strukturës së veterinarisë në organet e qeverisjes vendore. Kompetenca është hequr me ligj në vitin 2020, por në V.K.M nr. 683/2020 është lënë dispozitë tranzitore për të ushtruar kompetencat deri sa të implementohej struktura e AKVMB, e cila tashme është krijuar dhe në 8 shtator me urdhërin nr.366, datë 8.9.2021 ”Për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit në thertore dhe tregje” të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është caktuar data 15 tetor 2021, që të filloj aktiviteti në Thertore dhe Tregjet e kafshëve të gjalla nga veterinerët zyrtarë të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Element vlerësimi për planifikim është shuma 0 lekë.

5. Tarifa për leje, autorizimeve dhe vërtetime të lëshuara nga administrata e bashkisë dhe njësite administrative.

Nr	Emertimi	Niveli i tarifës	Numer	Vlera
1	Autorizim për vendosje banderolash të perkohshme	1 000 lekë	30	30,000
2	Autorizim për lëvizje të automjeteve (transport nxenesish, furnizim malli në subjekte, shërbime transporti në subjekte e të ngjashme.)	1 000 lekë	30	30,000
3	Tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta jo të rrezikshme nga të tretet në vendgrumbullimin e mbetjeve	100 leke/m ³	30,000	3,000,000
4	Autorizime të tjera	1 000 lekë	30	30,000
5	Autorizim për privatizimet e kryera	1 000 lekë	20	20,000
6	Autorizim për privatizimet e reja	5 000 lekë	10	50,000
7	Autorizim për ushtrim veprimtarie si Lavazh	10 000 lekë	10	100,000
8	Vërtetime të tjera	100 lekë	200	20,000
9	Për vërtetim pasurie e pronësie	500 lekë	100	50,000
10	Për vendime K.B të shkurtuara etj	100 lekë	10	1,000
11	Tarife shërbimi për D.D.D në të trete (leke / m ²)	500 lekë	10	5,000
12	Për dhënie të mjetit elektrik të bashkisë (leke / ore)	5 000 lekë	20	100,000
13	Për palestrat e shkollave të bashkisë jashtë orarit të mësimin	3 000 lekë	6	18,000
14	Nxjerrje dhe fotokopjim dokumente arkivore me kërkesën e të interesuarit	1000 leke	500	500,000
15	Të tjera			1,079,000
TOTALI				5,033,000

Element vlerësimi për planifikim është shuma 5,033,000 lekë

6.1 Tarifa e parkimit të automjeteve.

Nr	Emertimi	Niveli i tarifës	Numri	Vlefte
----	----------	------------------	-------	--------

	I-Automjete të lic.për transport pasagjerësh			
1	Automjete deri në 5 vende	1 750 lekë në vit	130	227 500
2	Automjete 6-9 vende	3 500 lekë në vit	17	59 500
3	Automjete 10-25 vende	4 000 lekë në vit	50	200 000
4	Automjete 26-42 vende	4 500 lekë në vit	5	22 500
5	Automjete mbi 42 vende	4 800 lekë në vit	5	24 000
	II- Automjete të lic.për transport mallrash			
6	Automjete deri në 2 ton	2 800 lekë në vit	20	56 000
7	Automjete 2-5 ton	4 000 lekë në vit	70	280 000
8	Automjete 5-10 ton	4 800 lekë në vit	40	192 000
9	Automjete 10-16 ton	5 000 lekë në vit	10	50 000
10	Automjete mbi 16 ton	7 500 lekë në vit	30	225 000
11	Parkim vjetor me pagesë për subjekte të miratuara	19 000 lekë në vit	80	1 520 000
	TOTALI			2 856 500

6.2 Tarifë për lejet dhe certifikatat e shërbimit të transportit.

Nr	Emertimi	Lloji i transportit	Nr. Licence (cope)	Nr. Certifikat e (cope)	Tarifa		Shuma leke	
					Licence	Çertifikate	Licence	Çertifikate
I	Subjekte taksi 4+1 dhe 8+1	taksi	40		20 000		800 000	
	Shuma I						800 000	
1	Trans. malli per vete	kamion		150		100l/ton		15 000
2	Trans . Malli per të tretë	kamion	5	30	40 000	100l/ton	200 000	3 000
II	Shuma 1+2						200 000	18 000
III	Transport rrethqytetes	Autobuz		50		1 500		75 000
	Shuma III							75 000
IV	Lic.agjensi transp. Ndërk.		2		40 000		80 000	
	Shuma IV						80 000	
V	Lic treg karburanti		10		1 000 000		10 000 000	

Shuma V						10 000 000	
Gjithsej						11 080 000	93 000

Element vlerësimi për planifikim (6.1 + 6.2) është shuma 14,029,500 lekë.

7. Tarifa e Shërbimit të Ujitjes

Ligji 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” ka për qëllim:

- të përcaktojë kuadrin institucional që t’i shërbejë një politike kombëtare për ujitjen, kullimin, mbrojtjen nga përmytja dhe erozioni;
- të përcaktojë kuadrin ligjor për krijimin dhe/ose funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit;
- të përcaktojë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë e juridikë që merren me ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja dhe erozioni;
- të rregullojë transferimin e sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja të drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat e përdoruesve të ujit. Sipas shkresës Nr. [redacted] prot, datë 22.11.2022 “Kthim përgjigje shkresës për informacion buxheti viti 2022” planifikohen të dhënat për këtë tarifë si më poshtë:

7.1 Tarifa vjetore e mirëmbajtës së infrastrukturës

Ne baze të ligjit ligjin 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” neni 17 dhe 19 janë përcaktuar tarifat dhe përlllogaritja e të ardhurave sipas aftësive ujitëse të sistemeve të ujitjes.

Nr.	Skema Ujitëse	Sipërfaqja në hektarë			
		Njësia Qendër	Njësia Shushice	Njësia Novosele	Njësia Orikum
1	VLU-3 Sistemi Llakatund	300	1300		
2	VLU-10 Sistemi Kallafet	660			
3	VLU-9 Sistemi Babice	500			
4	VLU-2 rezervuar Panaja	200			
5	VLU-57 Jonufer				80
6	VLU-6 Dukat - Tragjas				1150
7	VLU-8 Rezervuar Bunavi		130		
8	VLU-17 Bestrove	60			
9	VLU-52 Orikum, Lum Izvori				350
10	VLU -1+2 Myzeqe Vlorë			5550	
	Totali	1,980	1,430	5,550	1,580

Sipërfaqja totale nën ujë është 10,540 ha. Vlera e përlllogaritur për tu arkëtuar nga kjo tarifë është: 10,540 Ha x 200leke/ha = 2,108,000 leke

Element vlerësimi për planifikim është shuma 2,108,000 lekë

7.2 Tarifa e Ujitjes

Ne baze të ligjit ligjin 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” neni 18 dhe 19 janë përcaktuar tarifat dhe përlllogaritja e të ardhurave sipas sipërfaqes së mundshme për ujitje.

Aktualisht sipërfaqja për ujitje është 750 ha

Vlera e përlloragitur për tu arkëtuar nga kjo tarife është: 750Ha x 2500 lek/ha për çdo ujitje

Element vlerësimi për planifikim është shuma 1.875.000 lekë

Element vlerësimi për planifikim të kësaj tarife 7.1 dhe 7.2 është shuma 3.983.000 lekë.

II.4. TE ARDHURA TE TJERA

II.4.1 Te ardhura nga qiratë

a. Te ardhura nga qiratë e tokave.

Bashkia e Vlorës është e detyruar ti planifikoj te ardhurat nga viti ne vit sipas legjislacionit ne fuqi, por asnjëherë nuk janë realizuar pasi pronaret e objekteve qe posedojnë dhe truallin e tyre nuk e paguajnë. Konkretisht per vitin 2023 te ardhurat e parashikuara nga qiraja e tokes (truallit) dhe e objekteve eshte 6,100 mije leke. Theksojmë se mbledhjen e kësaj te ardhure nga data 10.06.2010 e arkëton Drejtoria Rajonale Tatimore.

Nga te dhënat e marra nga Drejtoria e Drejtimit te Pronës Publike ne Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 15184/1 prot., date 06.11.2015 si dhe V.K.M Nr.850, date 21.11.2007 “Për kriteret dhe procedurat e shitjes se trojeve te ndërmarrjeve shtetërore apo objekteve shtetërore te veçuar, te privatizuar“, te ndryshuar ne te cilën theksohet se *30% e te ardhurave nga kjo qira i takon qeverisjes vendore, nga këto 10% e çmimit është qira toke, kurse përfitimi i organeve te qeverisjes vendore qëndron po i njëjtte, pra 30% e te ardhurave (7.424 *10%*30%)*. Aktualisht nuk ka ndonjë ndryshim në procedurën e cituar më lart.

Ashtu sic kemi theksuar edhe vitin e kaluar, interesimi i subjekteve te cilët posedojnë objekte te marra nga ish AKP-ja, për te blere truallin nen objekt, te cilët duhet te paguajnë taksen e qerases se truallit , ne zbatim te ligjit Nr. 10270, date 22.04.2010 ”Për te drejtën e privatizimit te truallit shtetëror ne përdorim dhe për taksen mbi te drejtën e përdorimit te tij”, ka qene i ulet. Bazuar ne shkresën e mësipërme, rezulton se ne Bashkinë Vlorë është evidentuar një sipërfaqe prej 185 546 m².

Sipërfaqe 185 546 m²

Çmimi mesatar i qerases(sipas V.K.M-se për qytetin e Vlorës) 742.4 lekë / m² ne vit Çmimi i transferuar për llogari te Bashkisë (30%) 222.7 lekë / m² ne vit Te ardhurat nga qiratë e tokës (185 546 x 222.7) **41.324.805 lekë ne vit**

Element Vleresimi per planifikim është shuma 41,325 mijë lekë në vit

II.4.2 Te ardhura nga aplikimi i gjobave ne nivel vendor dhe rikthime

Ne këtë kategori te te ardhurave përfshihen :

Duke u nisur nga realizimi i te ardhurave për vitin 2022 planifikojmë për vitin 2023 te ardhurat si me poshtë:

Gjoba nga Policia Bashkiake (ne infrastrukture dhe parkime) 850 000 lekë

Gjoba nga Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik 3 000 000 lekë

Gjoba dhe te ardhura nga debitorë te ndryshëm 3 000 000 lekë

Debitorë nga tatim – taksat 70 000 000 lekë

Debitorë nga taksa dhe tarifa familjare nga sh.a. Ujesjelles Kanalizime Vlorë 36 000 000 lekë.

Sic është raportuar dhe gjate miratimit të buxhetit të vitit 2022 debiti i sh.a Ujesjellesit Vlore ndaj Bashkise është në shumen 92,627,771 lekë detyrim që rrjedh si diferencë nga viti 2021. Ky debit është krijuar gjate vitit 2021 dhe për shkak të gjendjes të vështirë ekonomike dhe financiare të sh.a Ujesjellesit gjate vitit 2022 arketimi i kësaj shume ka qenë në nivele të ulëta, nderkohe që faturimet e vitit 2022 për taksat dhe tarifën e Bashkise nga Ujesjelles sh.a si agjent tatimor janë arketuar rregullisht dhe kanë kaluar në llogarinë e Bashkise.

Nisur nga gjendja ekonomike dhe financiare e sh.a Ujesjellesir është rënë dakort dhe është nënshkruar marrëveshja përkatëse sipas të cilit krahas kalimit të shumës mujore të vitit 2023 të kalojë dhe 3 milion leke për llogarinë të debitit e barabartë me shumën vjetore 36 milion leke.

GJITHSEJ 112 850 mijë lekë

II.4.3 Te ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat

Duke u nisur nga realizimi i të ardhurave të vitit 2022 edhe për vitin 2023 planifikojmë të ardhurat e mëposhtme:

a. Te ardhurat nga çerdhet.

Për vitin 2022 parashikohet të frekuentojnë çerdhet:

Numri i fëmijëve 50

Tarifa mujore 3500

Vlera vjetore (50x3.500x11) **1.925 mijë lekë**

b. Te ardhurat nga kopshtet.

Për vitin 2022 parashikohet të frekuentojnë kopshtet:

Numri i fëmijëve mesatarisht që do të frekuentojnë 650

Tarifa mujore 3.500

Vlera vjetore (650x3.500x8) **18.200 mijë lekë**

c. Te ardhurat nga shkollat.

Për vitin 2022 parashikohet të frekuentojnë shkollat (Tregtare + Industriale)

Numri i nxënësve me pagesë 100 % 7

Tarifa mujore 6.365 lekë

Te ardhura totale (10 muaj) **446 mijë lekë**

Numri i nxënësve me pagesë 50 % 8

Tarifa mujore	3.183 lekë	
Te ardhura totale (10 muaj)	255	mijë lekë

GJITHSEJ 20.826 mijë lekë

II.4.4 TE ARDHURA TE TJERA DYTËSORE TE NJESIVE VARTËSE PËR VITIN 2023

Këto institucione gjate vitit 2023 planifikojnë të ardhura :

1. Te ardhura nga Teatri “Petro Marko”

- a. Te ardhura nga teatri 50 mije lekë
- b. Te ardhura nga estrada 400 mije lekë
- c. Te ardhura nga qira e sallës 100 mijë lekë

GJITHSEJ 550 mije lekë**2. Te ardhura nga Qendra Kulturore****a. Te ardhura nga biletat nga vizitat ne muze**

- Numri i vizitoreve 500
- Vlera e biletës 200 lekë
- Te ardhura gjithsej (500x200) **100 mije lekë**

b. Te ardhura nga qiratë e sallës

- Numri i aktiviteteve (te përkohshme) 25
- Tarifa e qerase 5000 lekë salla kati 20 Total 100.000 lekë
- Tarifa e qerase 20.000 lekë Kinema 5 Total 100.000
- Te ardhura nga qiratë **200 mije lekë**

c. Te ardhura nga qiratë e ambienteve

- Numri i subjekteve (aktivitet vjetor) 8
- Sipërfaqe totale e dhëne me qira 600 m²
- Tarifa e qerase 200 lekë / m²
- Tarifa e transferuar për llogari te Bashkisë (90%) 180 lekë / m²
- Te ardhura nga qiratë (200x600x12) **1.475 mije lekë**

GJITHSEJ 1,775 mije lekë**3. Te ardhura nga Klubi i Shumesportesh “Flamurtari”****a. Te ardhura nga ambientet me qira**

- Ambienti i palestrës mesatarisht 35 dite
- Tarifa e qerase 4.000 lekë / m²
- Te ardhura (35x4.000) **140 mije lekë**

b. Te ardhura nga qiratë e ambienteve te pallatit te sportit

- Numri i aktiviteteve (te përkohshme) 7
- Tarifa e qerase 50.000 lekë
- Te ardhura nga qiratë **350 mije lekë**

c. dhënie me qira te klubeve private

- numri i ndeshjeve 23
- tarifa 7.000
- te ardhura ne kjo qira **161 mije lekë**

GJITHSEJ 651 mije lekë**4. Te ardhura nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike**

Te ardhura nga qiraja e kabinave te plazhit **300 mije leke**

5. Te ardhura nga Pullat (e ardhura nga pullat 2021) 700 mijë lekë

II.4.5 TE ARDHURA TE TJERA NGA PROJEKTET

Vlera totale e përllogaritur për të ardhurat nga projektet me fonde të huaja përllogarit ne 19,200 mijë leke, ashtu si dhe vitin e kaluar zbatimi i këtyre projekteve ka filluar dhe janë në fazë implementimi, por ende nuk kanë filluar pagesat.

Ne zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 35, date 21.009.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” si dhe

në zbatim të pikës 26, të udhëzimit plotësues të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 20.01.2020, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, për njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projektit/eve, fondi i rimbursuar nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit/eve në fjale, i kalon njesise perkatese te veteqeverisjes vendore qe ka kryer shpenzimin nga te ardhurat e veta, ne masen e shpenzimit te kryer, dhe perdoret prej saj si e ardhur. Si rrjedhojë edhe për vitin 2023 duke qënë se projektet nuk janë certifikuar pavarësisht se Bashkia Vlorë ka realizuar disa shpenzime për projektet e huaja parashikimi i këtij fondi nga ana e Bashkisë Vlore për të kryer shpenzime të cilat do të disbursohen nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit duhet të bëhet në kapitullin 02.

Këto të ardhura do të planifikohen si të gjitha burimet e financimit të pushtetit vendor, me përjashtim të të ardhurave destinacioni i të cilave është i përcaktuar me ligj.

Nr.	Projekti	Planifikim KAP II
1	Invalor 101	8,000
2	SMENSËICT	20,000
3	Co-Clean	9,000
4	Effects	9,000
5	SUMO	18,000
6	BlueMed Plus	3,225
	Total	67,225

II.5. TE ARDHURA NGA BUXHETI I SHTETIT (TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR)

II.5.1. Te Ardhura Nga Buxheti i Shtetit, viti 2023

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe funksioneve të Bashkisë. Në këtë transfertë janë përfshirë edhe fondet për transferten e pakushtëzuar dhe transferten specifike për çdo funksion të transferuar nga pushteti qendror në atë vendor.

Sipas shkresës se Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 19206 date 19.10.2022, për vitin 2023 transfertat e përgjithshme për Bashkinë Vlorë paraqitet në shumën 1,121,850 mije lekë.

Ne zbatim të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, VKM nr.649, datë 10.10.2022 “Për propozimin e projektligjit për buxhetin e vitit 2023” janë dhënë fondet:

Për vitin 2023 transfertat e pakushtëzuara për Bashkinë Vlorë do të jete në shumën 674,396 mije lekë.

Për vitin 2023 transfertat e pakushtëzuara sektoriale për Bashkinë Vlorë do të jete në shumën 447,453 mije lekë.

nr.	Bashkitë	Transferatat e pakushtëzuara të përgjithshme 2023	Transfertat e pakushtëzuara sektoriale										Totali
			Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi Parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga Zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi I pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubet shumësportësh partizanë dhe studentë	
				Indivuale	Për stafin mbështetës								
60	Vlore	674,396	26,823	218,704	69,413	34,574	45,685	0	6,459	3,002	42,793	0	1121850

KAPITULLI III: PARASHIKIMI SHPENZIMEVE NE BUXHETIN E BASHKISE VLORE PËR VITIN 2023
PERMBLEDHESHE E SHPENZIMEVE

Emertimi	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PER VITIN 2023											GRANT+TE ARDHURA TOTALI								
	GRANTI						TE ARDHURAT													
	600	601	602	609	651	166	231	TOTALI	600	601	602		603	604	606	609	651	166	231	TOTALI
Administrata e Bashkise	109,140	14,000	20,000		50	2,600		145,790	157,746	31,159	176,492		9,950	2,500	0	0	0	84,769	462,616	608,406
Repetitorët			96				96		0	0	0				0	0	0	0	0	96
Mb.Dekori			4,010				4,010		0	0	0				0	0	0	0	0	4,010
Mb.Varreza			10,000				10,000		0	2,886	0				0	0	0	0	2,886	12,886
PMNZH							0	13,677	2,284	0	0				0	0	0	0	15,961	15,961
Administrimi i pyjeve dhe							0	0	0	0	0				0	0	0	0	0	0
Rrjeti Rrugor							0											124,614	124,614	124,614
Rrugët Rurale							0	513	0	0	0				0	0	0	0	513	513
Pastrimi			220,000				220,000		0	73,120	0				0	0	0	0	73,120	293,120
NMM	12,000	3,000			2,000	9,000	26,000	15,854	1,652	49,143	0				1,108	2,035	0	0	69,792	95,792
Gjelbërimi	25,000	5,000					30,000	30,450	4,000	8,850	0				0	0	0	1,740	45,040	75,040
Ujësjetjesi							0	0	0	0	0				0	0	0	0	0	0
Ind.Sherb.Publike	35,000	6,000	15,000				56,000	53,939	8,300	45,400	0				0	0	0	16,900	124,539	180,539
Pastrimi nd.s herb.publike	8,000	1,000	3,000				12,000	4,109	1,000	38,550	0				0	0	0	1,900	45,559	57,559
Zhvillimi I komunitetit							0	0	0	0	0				0	0	0	36,779	36,779	36,779
Nd.Ndricim rrugor	7,000	1,300	18,000				26,300	2,510	288	97,157	0				0	0	0	9,500	109,455	135,755
Kl.Shumesportesh	8,000	1,200	15,000				24,200	3,362	697	23,707	0				0	0	0	20,000	47,766	71,966
Futbolli							0	0	0	0	0				0	0	0	0	0	0
Qendra Kulturore	14,000	2,500	3,000				19,500	14,767	1,616	7,730	0				0	0	0	4,000	28,113	47,613
Teatri Petro Marko	16,000	3,000	3,000				22,000	6,615	600	6,450	0				0	0	0	3,200	16,865	38,865
Arsimi	10,000	2,000	16,000				28,000	20,586	3,107	53,993	0				0	0	0	33,866	111,552	139,552
Qendra PAK	5,000	1,000	1,000				7,000	4,246	470	3,610	0				0	0	0	2,000	10,326	17,326
Cerdhet+Qender	15,000	3,000					18,000	9,174	1,036	7,565	0				0	0	0	10,500	28,275	46,275
Shtepia e Femijes	4,500	1,000					5,500	3,030	257	2,000	0				0	0	0	770	6,057	11,557
Fondi I mbrojtjes civile+ fo							20,000	0	0	0	0				42,954	0	0	0	42,954	62,954
Projektet me fonde te huaj							0	0	0	0	0				0	0	0	35,803	35,803	35,803
SHUMA	268,640	44,000	328,106	20,000	2,050	11,600	674,396	340,578	56,466	596,653	0	9,950	2,500	42,954	1,108	2,035	386,341	1,438,585	2,112,981	

Shpenzimet e përgjithshme sipas natyrës ekonomike Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Bashkisë Vlorë për vitin 2023 parashikohet në vlerën **2,545,934 mije lekë**.

Ky parashikim mbështetet në objektivat e Bashkisë Vlorë të përcaktuara në programin afatmesëm.


Karakteristikat kryesore të shpenzimeve të programuara për vitin 2023 përcaktojnë:

- Procedura të buxhetimit të fokusuar tek produkti/rezultati, për çdo program ne veçanti.
- Racionalizim të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre, Shlyerjen e detyrimeve te prapambetura nga viti i mëparshëm.
- Rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes në shërbimet publike duke iu përgjigjur në këtë mënyrë tendencës të rritjes së investimeve në vite.
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
 - Të vlerësimit e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit,
 - Sigurimin e shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake,

ne buxhetin e vitit 2023 paraqiten si me poshtë :

Artikuj	Vlera 2021	Vlera 2022	Vlera 2023
Paga + Sig. Shoqërore (600+601)	902,850	1,000,976	1,114,124
Shpenzime Operative (602)	928,605	875,544	967,772
Subvencione (603)	45,780	25,177	0
Investime (231)	368,473	376,141	386,341
Te tjera (166,651,606,609)	125,665	110,634	92,197


SHPENZIMET SIPAS STRUKTURES BUXHETORE



■ paga+sig(600+601) ■ shpenz op(602) ■ investime(231) ■ te tjera(166+651+606+609)

Shpenzimet sipas Strukturës Buxhetore për grantin e pakushtëzuar + te ardhurat e veta

Shpenzimet sipas Strukturës Buxhetore	Vlera 2021	Vlera 2022	Vlera 2023
Paga + Sig. Shoqërore (600+601)	545,527	615,484	709,684
Shpenzime Operative (602)	888,648	837,629	924,759
Subvencione (603)	45,780	25,177	
Investime (231)	368,473	376,141	386,341
Te tjera (166,651,606,609)	110,493	110,634	92,197

**SHPENZIME PERSONELI (art.600 + 601)**

Shpenzimet për personelin janë parashikuar në masën 709,684,000 konkretisht:


1. Fondi i pagave i planifikuar për vitin 2023 do të jetë 609,218,000 lekë.
2. Për vitin 2023 shpenzimet e planifikuara për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jenë 100,466,000 leke.

SHPENZIME OPERATIVE DHE TE MIREMBAJTJES (art.602)


Për vitin 2023, në total shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë projektuar në shumën 924,759 mijë lekë.

Struktura e Shpenzimeve Operative	Vlera
Shpenzime për Shërbime Publike	585,116
Arsimi	69,993
Administrata	196,588
Shërbime Sociale	14,175
Kultura dhe Sporti	58,887

Struktura e Shpenzimeve Operative



Struktura e Shpenzimeve Operative për Shërbimet Publike



Shërbime Publike	Vlera
Pastrimi	383,813
Gjelberimi	8,850
Nd. Shërb. Publike	60,400
Mb. Dekorimi+Varreza	16,896
Nd. Ndricim Rrugor	115,157

Për të ruajtur dhe rritur nivelin e ofrimit të shërbimit shpenzimet janë planifikuar duke pasur parasysh :

- Koston reale për njësi të këtij shërbimi, duke përfshirë në të të gjithë elementet e pastrimit, si atë të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe atyre inerte, jo vetëm në rrugë, por edhe në ambientet e tregtimit. Për rritje të cilësisë së shërbimit janë përfshirë në kosto edhe elemente të tilla si larje speciale e rrugëve me presion, mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, dezinfektimin e tyre, pastrimin e rërës përgjatë bregdetit etj. Ofrimi i këtij shërbimi në ato zona ku nuk është ofruar më parë.
- Shtimin e gjelbërimit rrugor dhe pemëve dekorative.
- Analizën mbi gjendjen ekzistuese të sipërfaqeve për pastrim, të ndriçimit të rrugëve, si dhe nevojat e ndërhyrjes në mirëmbajtjen e tyre, mbështetur në koston për njësi të ndërhyrjes, si dhe vlerën përkatëse.

III.2. SHPENZIMET E DETAJUARA NE NIVEL PROJEKTI

Administrata Bashkisë Vlorë

Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim dhe Administrim)

Nr. 1	Projekti : Planifikim, Menaxhim dhe administrim Kodi : III.2.1	Llojet e programit : K01110 - Administrim, Menaxhim, Planifikim Funkzioni : Administrata Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
<p>Ky program parashikon menaxhimin financiar të institucionit të Bashkisë Vlorë dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore dhe përmbushjen e misionit për mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, të politikave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Ky program synon të përmbushë pikat e mëposhtme dhe jo vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë Vlorë dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj. • Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike të qytetit, • Ndërtimin e një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh, për të gjitha institucionet buxhetore, • Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me transparencë, efikasitet, ekonomike dhe implementimin e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm, • Krijimi i një institucioni eficient, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve, • Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, të shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë, • Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit, • Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut, • Të sigurohen kushte të ambienteve sipas standardeve higjieno – sanitare në funksion të një performace të standardeve sa më të larta për përmirësimin e kushteve të punës. 		

- Të sigurohet furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transporti në përdorim për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë sipas nevojave.
- Të rregullohet menaxhimi i aseteve të trashëguara në funksion të organizimit të Bashkisë, nëpërmjet likuidimit të detyrimeve të prapambetura, ose të trashëguara nga ish komunat.
- Të krijohet mundësia e dhënies zgjidhje për të gjithë automjetet, që administrohen tani nga Bashkia, duke filluar me procedurat e vlerësimit të këtyre automjeteve për nxjerrje në qarkullim sipas nevojave, riparimin e tyre duke bërë vlerësimin kosto përfitim ose për nxjerrje jashtë përdorimi.
- Të sigurohen parakushte për një qasje të integruar për trajtimin e problemeve në një shkallë të caktuar gjeografike si dhe të një koordinimi më të mirë ndërmjet politikave sektoriale dhe territoriale brenda vendit dhe më gjere.
- Të garantohet standardi i shërbimeve të pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve dhe pranimit të ftesave për bashkëpunim me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Të garantohen standardet për zbatimin e protokollit të Bashkisë Vlore në përmbushjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me përfaqësues apo institucione homologe të huaja në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Të përmirësohet qeverisja lokale në funksion të ofrimit të shërbimeve sipas standardeve të parashikuara, ndaj komunitetit
- Pajisje Zyre në gjendje të mirë pune të vlefshme për tu përdorur për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Vlore.
- Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Vlore dhe inventarit të tyre ekonomik.
- Ambiente me kushte të pranueshme fizike pune, për administratën vendore dhe për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarit në të gjitha godinat e Bashkisë.
- Rritja e imazhit përballë komunitetit për një prezantim sa më dinjitoz, përmirësimi i performancës së Policisë së Bashkiake dhe zbatimit të ligjit në shërbim të qytetareve.
- Ofrimin e shërbimit të internetit në Bashkinë Vlore dhe Njësitë Administrative të saj pavarësisht vendndodhjes gjeografike të tyre, konform standardeve të përcaktuara për komunikimin elektronik.
- Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit
- Bashkia Vlore synon Dixhitalizimin e Administratës Publike dhe kjo mundësohet në mbështetje të një infrastrukture shumë të mirë pajisjesh informatike (pajisjesh TIK).
- Mirëmbajtje e faqes zyrtare [ëeb ëëë.vlora.gov.al](http://ëeb.ëëë.vlora.gov.al) dhe moduleve të integruara të saj

- Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit, me synim ofrimin e qeverisjes elektronike duke forcuar një komunikim virtual dhe transparent Bashki – Qytetar dhe anasjelltas (G2C/C2G).
- Administrimi i taksave, nuk ka rëndësi vetëm në rritjen e të ardhurave dhe fondeve të disponueshme vendore, por ka rëndësi sepse ai mund të përdoret si instrument i domosdoshëm për politika fiskale vendore, instrument i cili do të inkurajonte biznesin në investime në infrastrukturë dhe që rrjedhimisht do të sillte uljen e nivelit të papunësisë dhe rritjen e nivelit të jetesës së komunitetit.
- Implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.
- Garantimi i masës së shpërblimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak për anëtarët e tij dhe kryetaret e fshatrave të Bashkisë Vlore dhe Njësive Administrative.
- Të përmirësohet siguria publike nëpërmjet sigurimit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpëtimit me qëllim rritjen e sigurisë së jetës dhe mbrojtjen e pronës së qytetarëve, bizneseve, asetëve administrative, pasurive natyrore dhe ambienteve të ndryshme publike.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Ndjekja dhe monitorimi i ofrimit të shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara paraprakisht.

1. Furnizim me ujë i Bashkisë dhe Njësive Administrative
 2. Furnizim me energji elektrike i Bashkisë dhe Njësive Administrative
 3. Furnizimi me gaz të lëngshëm për ngrohje
 4. Shërbim e postare
 5. Shërbim e telefonie fikse
 6. Shërbime të printimit dhe publikimit në media
 7. Shpenzim e të tjera (buqeta, kurora, lule)
 8. Rimbushje fikse zjarri
 9. Blerje kancelarie letër, bojë printeri dhe fotokopje
 10. Blerje dokumentacione (shtypshkrime)
 11. Kontrolli, riparimi dhe zëvendësimi vazhdueshëm i pajisjeve, materialeve elektrike, hidraulike dhe materialeve të tjera mbështetëse
- Identifikim i nevojës për pjesë këmbimi për automjetet e Bashkisë Vlore
 - Rimbursimi i udhëtimeve dhe dietave i administratës vendore në lëvizje për arsye pune brenda dhe jashtë vendit.
 - Vlerësim i të gjitha pronave, ndërtesave dhe inventarit ekonomik të tyre
 - Identifikimi i kërkesave për uniforma
 - Ofrimin e shërbimit të internetit në Bashki dhe Njësitë Administrative të saj pavarësisht vendndodhjes gjeografike të tyre, konform standardeve të përcaktuara për komunikimin elektronik.
 - Mirëmbajtja e pajisjeve TIK të parazgjedhura për një mundësi riparimi të tyre
 - Implikimet Teknologjike – Blerje Pajisje TIK të nevojshme
 - Mirëmbajtja e Faqes Ëeb të bashkisë, Integrimi me sistem e të tjera

- Garantimi i masës së shpërblimit të miratuar m e Vendim të Këshillit Bashkiak për anëtarët e tij dhe kryetareve të fshatrave të Bashkisë dhe Njësive Administrative sistematikisht dhe me korrektësi për çdo muaj.

b) Rezultatet e pritshme

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

- Përmirësimi kushteve të punës dhe përmbushja e detyrave në kohë për administratën e Bashkisë ashtu dhe për Njësitet Administrative,
- Krijimi i efikasitetit dhe efektivitetit në punë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë siç është furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër dhe bojë për printera e fotokopje, dhe shtypshkrim e për punonjësit.
- Rritjen e performancës dhe përmirësimin e punës në shërbimit të komunitetit.

Pastrim dhe mirëmbajtje higjienike e ambienteve të punës

Krijimi i kushteve bashkëkohore me standarde nëpërmjet sigurimit të ambienteve të përshtatshme, të pastra dhe me mjetet e nevojshme

Përmirësimi dhe funksionimi sipas standardeve të kërkuara të sistemeve elektrike, hidraulike dhe materialeve shtesë. Krijimi i kushteve optimale për ushtrimin e kompetencave të Bashkisë Vlore dhe Njësive Administrative. Furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit në përdorim për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Vlore sipas nevojave.

Rimbursimi i udhëtimeve dhe dietave të administratës vendore në lëvizje për arsye pune brenda vendit.

Realizimi i standardeve më të mira të kërkuara për pritjen e delegacioneve të huaja që vizitojnë Bashkinë Vlore dhe anasjelltas.

Sigurimi i dhuratave simbolike dhe tradicionale në kuadër të pritjeve dhe përcjelljeve të delegacioneve të huaja dhe kombëtare.

Pajisje Zyre në gjendje funksionale të vlefshme për tu përdorur për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Vlore.

Sigurim pranë shoqërive të sigurimit për ndërtesat në inventar të Bashkisë Vlore, të cilat përdoren për administratën e Bashkisë së Vlorës.

Ambiente pune të përshtatshme e fizikisht për kryerjen e detyrave dhe ofrimin e shërbimeve

Përmirësimi i mazhit të Policisë së Bashkisë

Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Vlorës

- Pajisje informatike me specifikim e teknike më të mira
- Sistem komunikimi elektronik më të qëndrueshëm
- Ofrim i shërbimeve elektronike më të sigurt
- Profesionalizëm, Cilësi dhe Korrektësi

Rezultat i pritshëm është që bashkia Vlore të zotërojë një faqe sa më ndërvepruese me vizitorin (user-friendly) të strukturuar në mënyrë të duhur dhe informacioni i kërkuar të jetë i kapshëm në të shumtën 3 klikime. Të arrihet gradualisht në gjendjen e ofrimit të qeverisjes së hapur ndaj qytetarit, duke bërë publike çdo vendim të institucionit dhe çdo informacion të tij. Të përftohet në mënyrë elektronike mendimi i qytetarit ndërmjet sondazheve on-line

dhe librarisë ligjore. Si rrjedhojë, ky mjet rrit transparencën, lufton korrupsionin dhe rrit korrektësinë & cilësinë e institucionit dhe administratës vendore.

Zgjidhja e propozuar bazohet në ndërtimin e një sistemi aplikativ informatik për administrim in e taksave dhe tarifave vendore bazuar ne aktet ligjore e nënligjore përkatëse

Shpërblimi në mënyre korrekt e dhe në kohë i anëtarëve të Këshillit bashkiak, kryetareve te fshatrave të Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative në përmbushje të funksioneve që ata kryejnë.

c) Aktoret e mundshëm	d) Kontributet e mundshme ne projekt
Bashkia Vlore	Buxheti i Bashkisë

e) Shpenzimet e llogaritura

Administrata e Bashkisë Vlorë për vitin 2022 planifikon shpenzimet e si me poshtë:

** Shpenzime për personelin (paga + sigurime shoqërore)

Pozicioni		Klasa	Paga Individuale	Shtesa për pozicion	Pagat
Kryetar	1			162,750	1,953,000
Zv/Kryetar	3			138,000	4,968,000
Keshilltar	7	IIIA/1	14,000 + 2%	68,700	7,534,800
Drejtor Kabineti	1	IIB	14,000 + 2%	85,000	1,272,000
Sekretar keshilli	1	IIB	14,000 + 2%	85,000	1,272,000
Sekretar kryetari	1	IVB	14,000 + 2%	40,600	739,200
Administrator Rajoni	5	III A/1	14,000 + 2%	68,700	5,382,000
Administrator NJA	4			85,000	4,080,000
Drejtor	15	IIB	14,000 + 2%	85,000	19,080,000
K/Inspektor	1	III A	14,000 + 2%	74,700	1,148,400
Pergjegjes	3	III A	14,000 + 2%	74,700	3,445,200
Pergjegjes	12	III A/1	14,000 + 2%	68,700	12,916,800
Specialist	98	III B	14,000 + 2%	57,000	91,728,000
Specialist	67	III B	14,000 + 2%	57,000	62,712,000
Specialist/kohe e pjesshme	3	IVA	14,000 + 2%	52,000	2,628,000
Specialist IT	1	IVA	14,000 + 2%	52,000	936,000
Inspektor	17	III B	14,000 + 2%	60,000	16,524,000
MB/ND	3			41,700	1,807,200
K/Inspektor P. Bashkiake	1		84,700	84,700	1,016,400
Inspektor P. Bashkiake	1		61,300	61,300	735,600
Punonjes P. Bashkiake	33		54,900	54,900	21,740,400
Totali i fondit te pagave v.2023					263,619,000
Totali i sig.shoqerore v.2023					44,024,373

Pagesa e 4 punonjësve për shërbimin mbështetës për fëmijë dhe familje.

Paga për këta 4 punonjës është 3,648,000 leke dhe sigurime shoqërore 610,000 lekë

Totali i fondeve te pagave për vitin 2023 – **267,267,000 leke**

Totali i fondit për sigurime shoqërore 2023 – **44,634,373 leke**

Shpenzime operative qe planifikohen për vitin 2023, paraqiten si me poshtë:

a. Shpenzime Operative		
Nr.	Emërtimi	Vlera 000/lekë
Shpenzime për shërbime baze		
1	Shpenzime për energjinë elektrike	3,500
2	Shpenzime për ujë (Bashkia+Rajon.)	3,200
3	Shpenzime për telefon-internet	1,500
4	Shpenzime postare+tarifen e shper. Ndhimes (shp.e invalideve)	2,700
5	Materiale pastrimi	800
6	Riparime hidraulike	800
7	Riparime elektrike	800
8	Mirëmbajtje pajisje elektronike	1,200
9	Shpenzime për ruajtjen e objekteve + sistem kamera për shkolla	38,700
10	Shpenzime për mirëmbajtje godine Bashkia + njësite	1,500
11	Shpenzime për sigurimin e objekteve dhe jetës	1,000
12	Shpenzime lysterje godine	1,000
13	Njoftime televizive	4,000
14	Shpenzime për pritje – përcjellje	300
15	Shoqata e Bashkive	2,000
16	Mirëmbajtje e faqes ëeb te Bashkise	800
17	Shpenzime gjyqësore + barra siguruese dhe hipotekore	2,250
18	Qira godine (Rajoni Nr.1)	840
19	Qira godine, ndihma + përkrahja sociale	720
20	Qira godine, zyra Aleat tek Conad	720
21	Qira godine, per grate e dhunuara dhe viktima të trafikut	800
22	Shpenzime për qendrën Vatra	640
23	Shpenzimet për Qendrën Kulturore Njësia Orikum	300
24	Transferim ne forme granti shoqata TID Vlora + Shpenzime te paparashikuara gjate vitit	1,200
25	Djeta brenda dhe jashtë vendit	2,500
	Shtypshkrime & kancelari	5,500
26	Shtypshkrime + kancelari	2,500
27	Boje printeri + fotokopje	3,000
	Shpenzime për transportin	24,000
28	Karburant, gazoil	14,500
29	Benzol	4,500
30	Riparim – shërbime – goma-pjese këmbimi taksa etj....	5,000
	SHUMA A (1-30)	97,770
Shpenzime te tjera për administratën		
31	Shpërblim për nxënësit cilësor	7,068
32	Shpërblime për: a. shpronësime V.K.M Nr. 898 dt. 21.12.2004, b. sipas V.K.M 121, dt. 25.02.2005 “Për krijimin e këshillave te kulturës”, c. V.K.M Nr.143, dt. 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit te nep.civil”	500
33	Shpenzime për mbrojtjen e tokës 40%	14,495
34	Bonus për strehimin	13,073
35	Shpenzime për gjendjen civile nga pullat	700
36	Projekti asistence për mbrojtjen e qeneve dhe maceve te rrugëve (vaksinimi-sterilizimi dhe dezinfektim i ambientit)	2,500

37	Shpenzime për veshje e zjarrëfikësve		3,000		
38	Shpenzime për invalidët e LANÇ		300		
39	Shpenzime te paplanifikuara gjate vitit		8,000		
	SHUMA B (31-39)		49,639		
Projekte, Kultureore e sociale etj.					
40	Festat për jetimet + te moshuarit		500		
41	Aktivitete mbi plan veprimin e rinise		300		
42	Suvenire te ndryshme (emblema, sete turistike etj....)		1,500		
Projekte te përmirësimit te shërbimit elektronik					
43	Mirëmbajtje Sistemi i Taksave dhe Tarifave		1,740		
	SHUMA C (40-44)		4,040		
	SHUMA I - A+B+C		151,449		
Shpenzime për Vendime gjyqësore dhe detyrime te tjera te prapambetura					
Nr.	Emër Mbiemër	Nr. Vendimit	Vlera Total	Detyrim I mbetur	Vlera e pagesës për 2023
1	Agim Varfi	Shuma e Detyrimit	585,255	585,255	585,255
2	Communication Progress	Shuma e Detyrimit	1,750,000	1,750,000	1,750,000
3	Agron Gjipali	Shuma e Detyrimit	3,237,000	3,237,000	3,237,000
		SHUMA II			5,572,255
SHUMA TOTAL (I+II)					157,021

Planifikim i fondeve në funksion të strehimit:

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” dhe të akteve ligjore në zbatim të tij, Administrata e Bashkise paraqet kerkesen per planifikim fondesh per vitin 2023 në funksion të plotësimit të kërkesave të familjeve, individëve të pastrehë, në një nga programet apo format alternative që parashikon ligji në fuqi.

Familjet që kanë kërkuar të trajtohen me banesa sociale me qera BSQ.

Në kushtet kur Bashkia Vlorë nuk disponon mundësitë e ndërtimit apo të blerjes nga tregu të banesave sociale me qera BSQ për familjet në kushtet e emergjencës për strehim që banojnë me qera në treg të lirë dhe nuk kanë mundësi të përballojnë me të ardhurat e tyre vlerat e qerasë, kërkojmë planifikimin e fondeve për subvencionimin e qerasë nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2023 si vijon:

- d. Për të subvencionuar pagesat mujore të qirasë për rreth 30 familje apo individë pa të ardhura, në ndihmë ekonomike, ose me pension invaliditeti, të cilat mund të përfitojnë subvencion deri në 100% të qirasë mesatare të tregut të lirë, nevojiten mesatarisht;

$$30 \text{ familje} \times 12500 \text{ lekë/muaj} \times 12 \text{ muaj} = 4,500,000 \text{ lekë}$$

- e. Për familjet që janë prekur janë zbatimimi I projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, ku në zbatim të VKM Nr.254 datë 9.5.2018, Bashkia Vlorë

duhet të financojë deri 50% të qirasë së tregut të lirë, deri në sistemin e banorëve me banesë, nevojiten mesatarisht;

20 familje x 7500x12muaj= 1,800,000 lekë

f. Për financimin e qirasë mujore për 10 familje që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë” nevojiten:

10 familje x 12,500 x 12muaj= 1,500,000 lekë

g. Në zbatim të VKBsë nr.63, datë 05.08.2020, lidhur me ambientin me destinacion kopeshit femijesh që ndodhet në katin përdhe të njërit prej pallateve të ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave tek zona e ish Frigoriferit, për të shlyer cmimin e shitjes te negociueshem midis palëve për vitin 2021 dhe për vitin 2022, nevojitet shuma:

2,636,708 X 2 = 5,273,416 lekë.

Totali a. + b. + c. + d. 13,073,416 lekë

Shpenzime për transferta tek Këshilli i Qarkut

Këshilli i Bashkisë mori parasysh te dhënat e paraqitura nga Grupi i punës për hartimin e buxhetit, mbështetur ne Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe Vendimin e Këshillit te Qarkut Nr.43, date 17.12.2014, “Për miratimin e kuotës se anëtarësisë për Bashkitë dhe Komunat ne buxhetin e Qarkut” përcakton për këtë kuotizacion (1%):

Te ardhurat e tatueshme për kuotizacion parashikohen: 994,977 mije lekë

Kuota ne % **1%**

Kuotizacioni për buxhetin e Qarkut **9,950 mije lekë**

Total Qarku Vlore 2023 9,950 mije lekë

d. Shpenzime për familjet ne nevoje 2,500 mijë lekë

Ashtu si edhe në vitin 2022 duke qënë se fondet e parashikuara kanë qënë të mjaftueshme edhe në vitin 2023 me të njëjtat fonde Bashkia Vlorë do të vazhdojë të ndihmojë familjet në nevojë në zbatim te ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 17/a, neni 20, pika 1, neni 21 ne te cilën theksohet se Këshilli i Bashkisë ka te drejte te miratoje kritere specifike për dhënie ndihme ekonomike apo për te ofruar shërbime te përkujdeset me fondet e pushtetit lokal për familjet me shume pjesëtare apo familjet e varfera, neni 29, pika 4/b, pika 9 ne te cilën theksohet se: me fondet e veta ne baze te kritereve specifike mbështetet me ndihme ekonomike apo forma te tjera ndihme te menjëhershme, familjet e varfera.

a. Në lidhje me aktivitetet sociale dhe përdorimin e fondit me të ardhurat e bashkisë të cilat nuk përfshihen në skemën e sistemit digjital dhe Fondit të kushtëzuar, kërkohet

një fond prej 1,800,000 Lekë (Bashkia + Njësitë Administrative) për trajtimin e këtyre familjeve të cilat parashikohen rreth 40, me të ardhurat e bashkisë duke zbatuar kriteret specifike bazuar në ligjin Nr.9355“ Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore.

- b. Për aktivitetet socio- ekonomike për tu ardhur në ndihmë familjeve me probleme sociale të thella dhe për komunitetet rome-egjiptiane, planifikohen 600,000 lekë për trajnimin e fëmijëve të këtyre kategorive të sipërpërmendura për trajtimin pa pagesë në kopshte dhe çerdhe për një periudhë 10 mujore.
- c. Shpenzime transporti për njesite ne evidentimin e rasteve te dhunes ne familje, 100,000 leke.

e. Shpenzime për aktivitete kulturore-artistike-sportive-sociale etj.

Bashkia edhe gjate vitit 2023 do të vazhdoj të mbështes me fonde financiare aktivitet artistiko-kulturore, sociale në qytetin e Vlorës si dhe në njësitë administrative. Edhe gjatë vitit 2023 aktivitetet bazë do të vijojnë të jenë ato kushtuar celjes të sezonit turistik, festave të 28 dhe 29 nëntorit si dhe festave të fundvitit.

JANAR, SHKURT, MARS

Gjate ketyre muajve shikohen kerkesat qe kane ardhur ne bashki per bashkesponsorizim. Kerkesat qe vijne jane nga me te ndryshmet. Mundohemi qe me vlera te vogla brenda mundesive te jemi perkrahes se te gjitha fushave, duke perfshire, artin, kulturen, sportin, botimin e librave te ndryshem, galeri, ekspozita dhe gjithcka qe ndikon ne rritjen e imazhit te qytetit. Per kete arsye bashkia behet bashkesponzoriues ne disa aktivitete qe shikon qe vlejne per qytetin duke i mbeshtetur ato dhe nepermjet komisionit te kultures qe gjykone ne baze te formularit te aplikimit

Festojme sebashku ditën e verës. 600,000

Ky projekt përmbledh në vetvete një sërë elementesh të ndryshme artistike, si kënga, vallja e kultivuar dhe ajo koreografike, elementi letrar me të gjitha zhanret e tij etj. Krijohet me të vërtetë një atmosferë e bukur festive, ku ka një masivizim më të madh të artistëve, për t'i dhënë seriozitet dhe nivel të lartë artistik. Kjo veprimtari është konceptuar në formën e një spektakli ku marin pjese kengetare te teatrit, maskota per femije, shperndahen tullumbace dhe nje atmosfere festive per ditën e verës. Tashme Dita e Verës është kthyer në traditë dhe festohet çdo 14 Mars

PRILL

Aktivitet në Nartë me rastin e Pashkëve 300,000

Në qendër të fshatit të Nartës, djemtë dhe vajzat e reja, të moshuar, kërcëjnë dhe këndojnë të veshur me rrobat më të bukura dhe plot ngjyra, ndërsa një pjesë tjetër të veshur me rrobat e karnavaleve kërcëjnë vallen popullore karakteristike në këto ditë Pashke.

Nartë Ndryshon sipas datave që bie Pashka

MAJ -Qershor-Korrik-Gusht

- 1. Sezonit Turistik “Lungomare on Fest” 2,700,000**
- 2. Albania Open 3,200,000**
- 3. Aulona Inter Folk 700,000**
- 4. Maratona e këngës 1,000,000**
- 5. Kalendar festiv për ditët e hapjes së sezonit 500,000**
- 6. Koncert për Ditën nderkombetare të Rinisë 300,000**

7.Festa e Kanines 300,000

1.Hapja e sezonit turistik ne Vlore ze pjesen me te rendesishme te gjithe vitit. Per kete arsye behet nje kalendar i ngjeshur aktivitetesh te cilat zhvillohen per marketimin e qytetit. Aktivitetet behen ne te gjithe qytetin. Marketimi i qytetit eshte shume i rendesishem ne kete periudhe pasi vizitohet shume nga turiste te huaj dhe vendas te cilet zgjedhin te kalojne pushimet e tyre ne Vlore.

2. Kampionati i Fluturimeve te lira eshte nje nga aktivitetet me te arrira. Në këtë kampionat marrin pjesë pilotë nga e gjithë bota.Ky kompeticion e ben Vloren te perjetoi jo vetëm sportin ekstrem, por edhe një javë kulturore qe e kethen bregdetin vlonjat në skenë të hapur natyrore mes sportit të qiellit dhe trashëgimisë kulturore në tokë.

3.Festivali Aulona Folk vazhdon të mbetet një manifestim i jashtëzakonshëm i folkut european e më gjerë si dhe një një promovim i rrallë i hapjes zyrtare të sezonit turistik të Vlorës. Një gërshetim i bukur i turizmit kulturor me turizmin natyror të rërës e ujit të detit.Edicioni i Parë i këtij Festivali është mbajtur në vitin 2009 duke shënuar të parin festival nderkombëtar folku në hapësirën mbarëshqiptare.Për nga standartet që realizon, gjeografinë dhe diversitetin e grupeve, nivelin e zhvillimit në të gjitha planet ky festival prej edicionit të dytë është kualifikuar nga CIOFF duke u bërë pjesë e kalendarit botëror që ky institucion prestigjioz kulture organizon në çdo vit kalendarik.

4.Maratona Kenge Moj” eshte nje BIG SHOË i cili eshte organizuar per shume vjet nga Shoqata “PROMOTOR” qe zhvillohet per cdo vit si nje feste e madhe muzikore dhe tashme eshte kthyer ne nje tradite te mirefillte..Ne te gjitha edicionet e deritanishme ne bashkepunim te ngushte dhe me Drejtorite e Qendrat e Kultures se bashkive,ka rezultuar mjaft I suksesshem dhe me nje audience maksimale.

Ne boshtin e ketij projekti eshte kenga qytetare, si edhe hitet e reja te muzikes shqiptare , por spektakli duke qene nje manifestim i vlerave muzikore, artistike, kulturore, do ti tejkalojte dimensionet e kenges. Natyrisht qe ne te, nje hapesire te rendesishme do te kete trashegimia e vlerave risjelle me tendencat e konceptet muzikore bashkekohore.Per te sjelle kete brume muzikor gjithmone ne te, marrin pjese artistet dhe personazhet me te spikatur te kenges.

5.Ne vazhdimesi caktohen aktivitete te ndryshme sportive, kulturore etj per gjithe sezonin turistik. Aktivitetet jane nga me te ndryshmet qe gjithe sezoni te jete i mbushur me gjalleri. Mendohen aktivitete ne te gjithe Vloren dhe ne pika turistike qe ka shume vizitore.

6. Dita Ndërkombëtare e Rinisë organizohet më 12 Gusht të çdo viti. Ajo është caktuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1999 me miratimin e rezolutës 54/120. Kjo ditë është menduar si një mundësi për qeveritë dhe të tjerët për të tërhequr vëmendjen për çështjet rinore në mbarë botën. Koncerte, seminare, ngjarje kulturore, që përfshijnë zyrtarë dhe takime kombëtare dhe lokale qeveritare dhe organizatat rinore zhvillohen ne botë në nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë. Të rinjtë kanë nevojë për hapësira të sigurta që të qëndrojnë së bashku, të angazhohen në aktivitete që lidhen me nevojat dhe interesat e tyre, të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes, si dhe të shprehen lirshëm. Hapësirat e sigurta sigurojnë dinjitetin dhe sigurinë e të rinjve.

7.Festa e Kanines tashme eshte kthyer ne tradite. Kanina, fshati që qëndron si ballkon mbi Vlorë, me një pamje të mrekullueshme mbi qytet, Festa e fshatit, përqëndruar në kalanë e Kaninës në një nga zonat më të mrekullueshme dhe historike të Vlores, mendohet te realizohet per te fokusuar sa me mire festat e tradites.Tashme cdo vit e me shume turistet qe e vizitojne kete concert dhe panair jane te shumte.

Element vlerësimi 9,000,000

SHTATOR

NENTOR

Vlora zë një vend të rëndësishëm qe perkon me daten 28 nentor 1912 , per Pavaresine e Shqiperise. Shqipëria u vetëshpall e pavarur në Vlorë më 28 nëntor 1912 nga Ismail Qemali. Ky projekt eshte përzgjedhur, sepse kjo veprimtari për vite e vite me radhë, është bërë traditë në qytetin tonë për të kremtuar me madhësi përvjetorin e Shpalljes së Pavarësisë që e ka selinë në Vlorë dhe çlirimin e Atdheut dhe është një veprimtari ku gërshetohen në mënyrë të harmonishme elementi letrar, kënga si dhe elementë të tjerë artistikë.

Do mendohet nje kalendar i pasur aktivitetesh per ti bere keto festa te pa harruara. Nepermjet festimeve te ndryshme pritet qe numri qe do te vizitoje Vloren do te jete shume i larte. Nje qytet qe do te jete gati per te mirepritur te gjithë dhe per te treguar historine qe i ka fillesat nga Vlora.

Është një veprimtari në kujtim të dy ngjarjeve të mëdha që e kanë ditëlindjen në muajin Nëntor.

Element vlerësimi 1,500,000

DHJETOR

Zhvillohen aktivitetet qe percaktohen ne vazhdimesi me rastine e festave te dhjetorit

Element vleresimi 2,000,000

Gjithashtu gjate vitit 2023 parashikohet te zhvillohet shfaqja nga estrada e te rinjve “Variete me humor”. Ajo do te shfaqet ne teatrin e qytetit dhe ne mjedise te ndryshme te Bashkise Vlore.

Vlera e ketij projekti eshte 360 mije leke.

Ne vijim te tradites do te vijoj realizimi I projektit “Panairi I turizmit familjar, ushqimeve dhe prodhimeve vendase” ne njesine administrative Orikum si kerkese e grave dhe vajzave te kesaj zone per te nxitur turizmin familjar.

Vlera e ketij projekti eshte ne shumen 330 mije leke.

Institute Shqiptar I studimeve nderkombetare ka mar te drejten e botimit ne shqip te librit “Floëer of Vlora, (Lulja e Vlores) me autore Anna Kohen. Libri do te botohet ne gjuhen shqipe ne tetor 2022 dhe do te jete nje kontribut I cmuar per vete qytetin e Vlores ne kuader dhe te ndertimit te Muzeut Hebraik te Vlores.

Vlera e ketij projekti eshte 960 mije leke.

Element vleresimi per aktivitetet artistiko kulturore eshte 14,750 mije leke.

f. Shpenzime për Dekorin e Shen Valentinit, Festa e Pavaresise dhe Festat e Fund Vitit. Për vitin 2023 Bashkia e Vlorës parashikon plotësimin e dekorit të qytetit duke shfrytëzuar edhe dekorin e përdorur në dy vitet e fundit për zbukurimin e qytetit dhe të njësive administrative. Dekori do të përfshijë dekorin për Shen Valentinin, festën e pavaresisë dhe festat e fundvitit.

Element vleresimi total 6,257 mijë leke

Element vleresimi pika e dhe pika f 21,007 mijë leke.

h. Këshilltaret 17,491,800 mijë lekë

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Vlefte vjetore
1	Honorare për Këshillin (1/10 e pages së kryetarit)	51	16,275	9,960,300
2	Kryetarët e Fshatrave (Kryepleqte)	36	8,500	3,672,000
3	Sekretari i Këshillit, page, sigurime shoqërore	1	93,000	1,272,000
4	Specialist arshiva, page, sigurime shoqërore	1	55,000	936,000
5	Specialist marrëdh. publik, page, sigurime	1	56,520	936,000
	Totali pagave e honorareve			16,776,300
6	Botime periodike (raporti vjetor i veprimtarisë së keshillit, gazeta juridike e keshillit, fletpalosje)			40,000
7	Botime të tjera: përmbledhje 4 vjeçare e vendimeve të Këshillit			50,000
8	Blerje karta urimi për festat zyrtare			15,000
9	Dërgim me postë i dokumenteve, shkresave të keshillit dhe keshilltareve			12,000
10	Kancelari për zyrë			40,000
11	Mirëmbajtje pajisje kompjuterike			30,000
12	Kompjuter zyrë (2 cope)			140,000
13	Printer (2 cope)			50,000
14	Rafte			50,000
	Total shpenzime operative zyrë KB			427,000
12	Shpenzime të paparashikuara (kontigjencë - 2% e totalit)			288,500
	TOTALI I SHPENZIMEVE			17,491,800

Buxheti i Këshillit Bashkiak Vlorë i detajuar sipas zerave dhe në %

